



BiEPAG



Policy Brief

Ballkani Perëndimor në Kohërat e Pandemisë Globale

Prill 2020

Florian Bieber dhe Tena Prelec, Marika Djolai, Donika Emini, Jovana Marović, Srdjan Majstorović, Vedran Džihic, Alida Vračić, me kontribute nga Nikos Tzifakis, Natasha Wunsch dhe miqtë e BiEPAG, Will Bartlett për kujdesin shëndetësor dhe sigurinë sociale, dhe Richard Grieveson dhe Mario Holzner (WIIW) për implikimet ekonomike

Rreth BiEPAG

Grupi Këshillues i Politikave të Ballkanit në Evropë (BiEPAG) është iniciativë bashkëpunimi Fondit Evropian për Ballkanin (EFB) dhe Qendrës për Studime të Evropës Juglindore të Universitetit të Graz-it (CSEES) që ka për qëllim promovimin e integritit evropian të Ballkanit Perëndimor dhe konsolidimin e vendeve demokratike dhe të hapura në rajon. BiEPAG përbëhet nga studiues të dalluar të politikave nga Ballkani Perëndimor dhe Evropa më e gjerë që shquhen për njohuritë dhe kuptimin e tyre për Ballkanin Perëndimor dhe proceset që formojnë rajonin. Anëtarët e tanishëm të BiEPAG janë: Dimitar Bechev, Florian Bieber, Srđan Cvijić, Milica Delević, Srđan Majstorović, Natasha Wunsch, Marika Djolai, Vedran Džihic, Dejan Jović, Marko Kmezić, Jovana Marović, Milan Nič, Corina Stratulat, Nikolaos Tzifakis, Alida Vračić, Shpend Emini, Zoran Nechev, Tena Prelec, Donika Emini, Jelena Vasiljević, Gjergj Vurmo dhe Matteo Bonomi.

Përmbledhje Ekzekutive

Pandemia globale e COVID-19 dhe masat e marra nga qeveritë në mbarë botën përbëjnë shkëputje të madhe në qasjen “punëve si zakonisht”, dhe kjo përfshin edhe Ballkanin Perëndimor. Pandemia është duke i lënë në hije zhvillimet e tjera, ndërsa gjithashtu po i përshejton tendencat ekzistuese, dhe do të vazhdojë ta bëjë këtë.

Kjo analizë vendos pandeminë e COVID-19 si udhëkryq kritik, një krizë që mund të tronditë në mënyrë të përhershme institucionet dhe shoqëritë. Ekzistojnë rreziqe të konsiderueshme përtej ndikimit të pandemisë në jetën e njerëzve, duke filluar nga një krizë ekonomike e cila mund të dalë të jetë më e keqe se ajo në vitet 2008/9, deri në një krizë të theksuar të demokracisë dhe zhvendosje gjeopolitike. Asnjë nga këto zhvillime nuk është e pashmangshme dhe disa nga pasojat e pandemisë së COVID-19 për Ballkanin Perëndimor mund të zbuten.

Duke hulumtuar nëntë fusha kritike, kjo analizë nxjerrë në pah mënyrat se si pandemia dhe përgjigjet e qeverive ndaj kësaj krize përbëjnë sfida të veçanta: 1. Roli i shtetit, 2. Demokracia dhe kapja e shtetit, 3. Zhvendosjet gjeopolitike, 4. Nacionalizmat e rinj, 5. Rezilienca shoqërore, 6. Ndikimi mjedisor, 7. Migrimi dhe kujdesi shëndetësor, 8. Kujdesi shëndetësor dhe mbrojtja sociale, dhe 9. Implikimet ekonomike.

Për të gjitha fushat kritike të lartë-përmendura, ky hulumtim shqyrton ndikimin, përshkruan rreziqet sidhe mundësitë potenciale para se të identifikojë intervenimet specifike që do të mund të parandalojnë pasojat më të këqija për rajonin.

Në përgjigjen e saj ndaj emergjencës, BE-ja duhet të përfshijë të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor në planet e asistencës dhe rindërtimit pas emergjencës, pavarësisht nga statusi i bisedimeve të tyre për aderim. Përfshirja e plotë e rajonit është vendimtare për të parandaluar pasojat e rënda ekonomike dhe ndryshimet gjeopolitike. Mbështetja për të kapërcyer efektet ekonomike dhe sociale pas krizës do të duhej të kushtëzoheshin me masa për të zvogëluar kapjen e shtetit.

Pandemia nuk mund të jetë arsyetim për pezullim të palimituar të demokracisë, ndërsakufizimet e lirive civile duhet të jenë të përkohshme, proporcionale dhe transparente. BE-ja duhet të identifikojë dhe të monitorojë kufizimet që ndërlidhen me institucionet demokratike dhe liritë civile që janë të lejueshme gjatë gjendjes së jashtëzakonshme në Ballkanin Perëndimor. Pas pandemisë, marrëdhëniet shtet-shoqëri duhet të rindërtohen dhe shtetet e rajonit duhet t'i japin prioritet më të lartë komunikimit dhe edukimit të popullatës në vend të shtypjes së tepërt. Përhapja e lajmeve të rreme luftohet më së miri me komunikim të qartë dhe të hapur, jo me anë të kufizimeve dhe censurës.

Grupeve të cënueshme, siç janë romët, duhet t'u ipet qasje në kujdesin shëndetësor dhe të mbrohen nga diskriminimi. Kriza mjedisore në rajon nuk do të zgjidhet, as nuk do të zbutet, dhe do të përballet me riskun e anashkalimit për hir të rimëkëmbjes së shpejtë ekonomike. Kombinimi i trafikut të zvogëluar të automjeteve gjatë izolimit dhe nivelet rekorde të larta e të vazhdueshme të ndotjes së ajrit kanë shpërfaqur urgjencën për veprim vendimtar në rregullimin e industrisë së rëndë: shumë fabrika të mëdha vazhdojnë të shkelin standardet mjedisore dhe të rrezikojnë shëndetin e qytetarëve.

Për të adresuar pasojat ekonomike dhe sociale, qeveritë do të duhej të mbështesin Ndërrmarjet e Vogla dhe të Mesme në veçanti, duke siguruar gjithashtu furnizimin me ushqim për grupet e cënueshme. Më në fund, futja e përkohshme e të ardhurave bazike universale do të mund t'i ndihmonte qytetarët që kanë humbur burimin e të ardhurave për jetesë.

Ekziston nevojë afatshkurtër por edhe afatgjatë për të përmirësuar cilësinë e spitaleve për sa i përket pajisjeve, furnizimit adekuat me barna dhe uljes së mbipopullimit të reparteve spitalore për trajtim akut, së bashku me rritjen e pagave për stafin spitalor për të siguruar mbajtjen e tyre në vend të punës. Është e nevojshme një qasje e përbashkët nga qeveritë dhe vendet anëtare të BE-së për të adresuar mungesën e personelit mjekësor për shkak të migrimit nga rajoni, gjë që paraqet tendosje shtesë për kujdesin shëndetësor.

Kërkohet kombinim i kujdesshëm i masave afatshkurtra dhe afatgjata për të parandaluar shndërrimin e pandemisë në një fatkeqësi të gjatë për Ballkanin Perëndimor. Kriza gjithashtu i ka dhënë vizibilitet më të madh shumë dobësive

strukture në rajon, nga sistemet e dobëta të kujdesit shëndetësor, besimi i ulët te shteti, deri te demokracia e dobët dhe kapja e shtetit, ndërsa në të njëjtën kohë ka zgjuar vetëdijen qytetare dhe shërben si shtytje për rritjen e solidaritetit ndërmjet qytetarëve. Vendosja e vëmendjes te dobësitë mund të ndihmojë në trajtimin e tyre dhe në ndërtimin e shoqërive më reziliente.

Ballkani Perëndimor në kohërat e pandemisë globale

Marsi i vitit 2020 ka mundur të jetë një muaj i mirë për Ballkanin Perëndimor. Pas vonesës prej më shumë se një vit e gjysmë, shtetet anëtare të BE-së më në fund i dhanë dritën e gjelbër fillimit të hapjes së negociatave me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut. Vetëm disa ditë më vonë, Maqedonia e Veriut iu bashkua NATO-s si anëtarja e saj e 30-të. Asnjë muaj në vitet e fundit nuk kishte ofruar aq shpresë se potenciali i reformës dhe integritit euroatlantik është i gjallë. Megjithatë, këto arritje që erdhën pas shumë vitesh në pritje, veçanërisht për Maqedoninë e Veriut, janë lënë në hije nga pandemia globale e COVID-19.

Pandemia nuk i ka ndalur të gjitha proceset që sjellin Ballkanin Perëndimor¹ më afër BE-së, dhe BE-ja është përgjigjur duke ofruar resurse plotësuese për rajonin për të luftuar pandeminë dhe për t'u marrë me pasojat ekonomike.

Sidoqoftë, pandemia dhe përgjigjet nga shtetet kanë dhe do të vazhdojnë të kenë ndikim të fortë dhe të qëndrueshëm në Ballkanin Perëndimor. Kufijtë janë mbyllur, ekonomitë janë shembur, gjendjet e jashtëzakonshme janë futur në të gjitha vendet, qoftë zyrtarisht ose *de facto*, qytetarët janë në izolim, zgjedhjet janë shtyrë dhe pandemia paraqet kërcënim vdekjeprurës për njerëzit në Ballkanin Perëndimor, si edhe kudo gjetiu në botë.

Shumëçka është e paparashikueshme meqë kostot njerëzore, politike, sociale dhe ekonomike të pandemisë mbeten të paqarta. Për më tepër, periudha dhe kohëzgjatja e gjendjes së jashtëzakonshme mbetet e panjohur. Megjithatë, është e qartë se nuk ka gjasa për kthim të shpejtë në gjendjen para pandemisë.

1 Samiti i BE-së për Ballkanin Perëndimor i planifikuar për maj 2020, nën kujdesin e presidencës kroate të Këshillit të Bashkimit Evropian, u desh të shtyhej për në qershor dhe mbase do të tkurret në formatin e një video-samiti.

Së këndejmi, ekziston nevoja për të vlerësuar dhe për të paraprirë efektet e pandemisë në Ballkanin Perëndimor. Siç përshkruhet në këtë analizë, pasojat e mundshme janë shkatërruese. Resurset shtetërore, veçanërisht sistemet e kujdesit shëndetësor, janë në gjendje të brishtë dhe nuk mund të përballojnë shpërthimet serioze të COVID-19, siç janë ato që tronditën sistemet e kujdesit shëndetësor në Itali, Spanjë apo Francë, të cilat në radhë të parë janë shumë më të pajisura. Demokracitë janë të dobëta dhe institucionet janë të thyeshme dhe së këndejmi paraqesin risk për mosqenien në gjendje për t'u rimëkëmbur shpejt nga masat e jashtëzakonshme të marra në mbarë rajonin. Shoqëritë do të tronditen nga pandemia; politikat shtetërore, institucionet publike dhe ekonomitë nuk ka gjasa të rimëkëmben shpejt.

Nuk ka asnjë rezultat përfundimtar të vetëm nga pandemia dhe veprimet e ndërmarra si përgjigje; në fakt, krejt varet nga hapat që po ndërmerren tani nga qeveritë dhe aktorët e tjerë të rëndësishëm, siç është BE-ja, për të shmangur skenarin e rastit më të keq.

Parashikimi i së ardhmes është gjithmonë përpjekje me risk, si për studiuesit ashtu edhe për analistët, meqë ka më shumë të ngjarë ta kemi gabim sesa të kemi të drejtë. Kjo vlen edhe më shumë në momentet e tronditjes globale, siç është pandemia e COVID-19 dhe përgjigjet e shteteve ndaj saj. Ne nuk e dimë as sa do të zgjasë gjendja aktuale, as çfarë do të jetë jehona e saj. Megjithatë, është e qartë se ky moment paraqet atë që politologët e kanë quajtur udhëkryq kritik, moment në të cilin mund të ndodhin ndryshime dhe zhvendosje në shkallë të gjerë, sepse *status quo* është vënë në pikëpyetje thelbësore. Kështu, në vend që të parashikojmë rezultatin dalës, ne do të përvijojmë fushat kritike dhe tendencat kundërthënëse dhe konkurruese të cilat u bënë të dukshme gjatë krizës në javët e fundit.

Udhëkryqi kritik është moment në të cilin mund të ndodhin ndryshime të mëdha me shpejtësi të nxituar. Ky udhëkryq është i lidhur ngushtë me konceptin e varësisë nga shtegu: pasi të vendoset shtegu i caktuar, thotë argumenti, është më e vështirë të devijosh nga kahu i vendosur në fillim.

Pandemia e COVID-19 është krizë e një madhësie që padyshim mund të ndryshojë rrjedhën e historisë. Në disa aspekte, ajo ka vepruar tashmë si përsheptues i tendencave para-ekzistuese, siç janë kriza e demokracisë dhe nacionalizmi. Në aspektet e tjera, siç është rishfaqja e shtetit kombëtar dhe de-globalizimi i vullshëm, ajo ka ndryshuar botën, përfshirë Ballkanin

Perëndimor, brenda vetëm pak javësh. Në këtë hulumtim, ne shqyrtojmë nëntë fusha në të cilat pandemia dhe përgjigjet nga qeveritë ka të ngjarë të kenë impaktin më të madh: 1. Roli i shtetit, 2. Demokracia dhe kapja e shtetit, 3. Zhvendosjet gjeopolitike, 4. Nacionalizmat e rinj, 5. Rezilienca shoqërore, 6. Ndikimi mjedisor, 7. Migrimi dhe kujdesi shëndetësor, 8. Kujdesi shëndetësor dhe mbrojtja sociale, dhe 9. Implikimet ekonomike.² Përveç përvijimit të ndikimit, në secilën pjesë do të paraqiten skenarët e mundshëm që mund të dalin si rezultat, dhe do të ofrohen ndërhyrjet që mund t'i vendosin shoqëritë e Ballkanit Perëndimor në një shteg që do të shmangë pasojat më të këqija dhe do të mobilizojë zhvillimet pozitive.

Roli i shtetit

Të jetosh gjatë krizës së COVID-19 është sfiduese për të gjithë. Në nivel emocional, përgjigjet e njerëzve shkojnë nga paniku dhe frika e drejtpërdrejtë deri te mosbesimi dhe zemërimi drejtuar autoriteteve dhe shtetit, duke zbuluar kështu mosbesimin e rrënjosur thellë ndaj këtij të dytit. Në të njëjtën kohë, ekziston pritshmëria e mbrojtjes dhe e sigurisë. Këto ditë, shumë njerëz janë bllokuar në shtete në të cilat ata nuk janë shtetas, me dëshirë ose si rezultat i rrethanave. Parakushti kryesor për marrëdhënie pozitive ndërmjet qytetarëve, banorëve dhe shtetit është besimi. Në kohërat e pandemisë globale ai mbështetet në tre standarde si vijon: informacioni i saktë, mbrojtja e menjëhershme (shëndetësia dhe shërbimet publike) dhe zmbarsja e impaktit negativ ekonomik për stabilitetin afatgjatë.

Në këtë pikën e fundit, dy pyetje thelbësore u shfaqën muajt e fundit: çka është i gatshëm një shtet të bëjë, në kuptim të zotimit dhe përkushtimit të mirëfilltë të qeverive për të luftuar impaktin e krizës së COVID-19, dhe cilat janë kufizimet e tij të vërteta? Kriza i ka vendosur shtetin dhe qeverinë në ballë të betejës, dhe në shumicën e vendeve përgjegjësia për t'iu përgjigjur krizës po ndahet ndërmjet qeverive kombëtare, rajonale dhe lokale. Me fjalë

2 Kontribuues kryesorë: Florian Bieber, Tena Prelec, Hyrje, Marika Djolai, Roli i shtetit; Donika Emini dhe Jovana Marović, Demokracia dhe kapja e shtetit; Srdjan Majstorović, Zhvendosjet gjeopolitike; Vedran Džihic, Nacionalizmat e rinj; Tena Prelec, Marika Djolai, Rezilienca sociale, Impakti mjedisor; Alida Vračić, Migrimi dhe kujdesi shëndetësor; Will Bartlett, Kujdesi shëndetësor dhe mbrojtja sociale, dhe Richard Grieveson dhe Mario Holzner (WIIW), Implikimet ekonomike.

të tjera, kriza e ktheu qeverinë në mënyrë domethënëse.³ Dhe, vlerësimi vjen te ky rol i vijës së parë të fronit. Ai bazohet në matjen e saktësisë së informacionit në lidhje me krizën dhe suksesin e shteteve në mobilizimin e resurseve dhe zhvillimin e qasjeve të duhura për mbrojtjen e qytetarëve, duke përfshirë vazhdimësinë e shërbimeve pa ngecje. Ajo që ka më shumë rëndësi këto ditë është sukseesi i shtetit për të ndikuar drejtpërdrejt dhe për të frenuar sjelljen e qytetarëve, përfshirë distancën sociale dhe bindjen e njerëzve për të qëndruar brenda shtëpive të tyre.

Trajtimi i krizës së COVID-19 nga shtetet në Ballkanin Perëndimor ka qenë më se i diskutueshëm. Në Serbi, ushtria është duke i patrulluar rrugët, e pajisur me armë zjarri për zbatim detyrues të orës policore të vendosur nga qeveria. Orë policore të ngjashme të gjata që prekin qytetarët, veçanërisht të moshuarit, janë imponuar në të gjitha vendet e rajonit. Fokusi kryesor i shtetit është zbatimi detyrues i distancës fizike nëpërmjet masave kufizuese dhe represionit, duke përfshirë dënimet e larta, në vend të edukimit dhe komunikimit. Kjo qasje zbulon se marrëdhënia ndërmjet shtetit dhe shoqërisë në mbarë rajonin formohet nga mosbesimi i ndërsjellë. Por, këto masa drakoniane nuk mund të fshehin dobësitë e sistemit të kujdesit shëndetësor - ai nuk është sjellë në nivel të standardeve moderne për shkak të mungesës së vullnetit dhe investimeve, dhe është cenuar nga eksodi masiv i stafit mjekësor të trajnuar dhe me përvojë, të cilët po migrojnë jashtë vendit në kërkim të kushteve më të mira të punës dhe pagave më të larta. Kjo lënie pas dore në mënyrë sistematike e sistemit të kujdesit shëndetësor,⁴ që vjen në shprehje në të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor, si dhe në rrethinë të tij, tani u bë e dukshme në vazhden e krizës që çoi në dështim të përpjekjeve për të mbrojtur qytetarët. Në fakt, lënia pas dore e sistemit të kujdesit shëndetësor rriti gjasat e nevojës për masa të ashpra, meqë spitalet kanë më pak resurse për t'i trajtuar rastet e rënda, gjë që rriti urgjencën për të parandaluar ndonjë përhapje të mëtejshme të COVID-19.

Në pikën e informacionit të saktë dhe të besueshëm, mediet luajnë rol kyç. Tani që njerëzit janë në izolim, ata po i kushtojnë më shumë kohë

3 Ivan Krastev, "Seven early lessons from the COVID19," ECFR, 18 March 2020. https://www.ecfr.eu/article/commentary_seven_early_lessons_from_the_COVID19

4 Economist Intelligence Unit, Modernising Health Care Systems in the Balkans. Uneven Progress, 2016, https://eiperspectives.economist.com/sites/default/files/Modernisinghealthsystemsinthebalkans_0.pdf

informacionit në lidhje me krizën e COVID-19 dhe përmbajtjeve të tjera, veçanërisht në mediet sociale. Sektori i medieëve në rajon është tashmë i dobësuar për shkak të presionit të vazhdueshëm nga qeveritë autokratike dhe për shkak të rënies së demokracisë. Vendet janë vërshuar nga teoritë e konspiracionit dhe lajmet e rreme në mediet tradicionale dhe në mediet sociale, duke e ushqyer frikën, thashethemet dhe paragjykimet. Mediet e kontrolluara nga qeveria në Serbi, si Kurir dhe Informer, po mbjellin panik dhe po përflakin situatën. Përhapja e panikut dhe lajmeve të rreme ka qenë aq e përhapur në Bosnjë dhe Hercegovinë, sa që përfaqësuesi i OSBE-së për lirinë e medieëve u ndie i detyruar të shprehte shqetësimin e tij me një deklaratë.⁵

Mungesa e informacionit të besueshëm dhe të saktë, e kombinuar me deklaratat të papërgjegjshme nga zyrtarët e qeverisë, shton stresin kolektiv dhe shkatërron besimin te shteti. Për shembull, Branimir Nestorović, mjek dhe anëtar i task-forcës për të luftuar përhapjen e pandemisë, në fund të shkurtit u bëri thirrje grave që “të bëjnë shopping në Itali, tani janë uljet më të mira” dhe e përshkroi virusin si shaka në një konferencë shtypi me presidentin serb.⁶ Disa media në mbarë rajonin përhapën pretendime se popullsia ishte gjenetiksht immune ose promovuan ilaçe të rreme. Nga ana tjetër, qeveritë kanë abuzuar me kompetencat e gjendjes së jashtëzakonshme për të shtypur mediet e pavarura, siç tregohet nga arrestimi i Ana Lalić më 1 prill për kritikën lidhur me gatishmërinë e sistemit të kujdesit shëndetësor në krahinën serbe të Vojvodinës. Ndërsa ajo u lirua me shpejtësi dhe dekreti që arsyetonte arrestimin u revokua, ky veprim theksoi rreziqet e përgjigjes shtetërore ndaj lajmeve të vërteta dhe gjoja të rreme.

Raportimi çorientues, përfshirë atë nga mediet e afërta me qeveritë, si dhe deklaratat çorientuese nga vetë qeveritë, kanë gërryer besimin shoqëror, duke përfshirë besimin e qytetarëve te shteti. Si rezultat, disa qytetarë nuk i kanë marrë seriozisht masat e rekomanduara të izolimit dhe karantinës. Të tre dimensionet e besimit ndërmjet qytetarëve dhe shtetit në Ballkanin Perëndimor janë të dobëta, ndërsa kriza zbuloi shtrirjen e plotë të dështimeve sistimore afatgjata të institucioneve kryesore shtetërore. Si rezultat, shtetet po dështojnë t’i mbrojnë qytetarët e tyre nga COVID-19. Ka

5 “OSCE Concerned About Measures Against ‘Fake News’ In Bosnia,” RFE/RL, 24.3.2020, <https://www.rferl.org/a/osce-concerned-about-measures-against-fake-news-in-bosnia/30507012.html>

6 “Doktor Nestorović se obratio JAVNOSTI i otkrio je NAJVAŽNIJE stvari o KORONA VIRUSU: ‘Žene, požurite u Italiju u šoping sad su tamo najveći popusti’”, Novosti, 26.2.2020.

pak të ngjarë që aktorët e jashtëm, duke përfshirë BE-në, mund t'i mësojnë qeveritë e Ballkanit Perëndimor që të kujdesen për qytetarët e tyre në mënyrë të mirëfilltë, por ata mund të bëjnë përpjekje për të mbështetur shtyllat e besimit - mediet, shërbimet e shëndetit publik dhe ekonominë - për t'i forcuar shtetet në kohëra të krizave, pa rezultuar në autoritarizëm të plotë.

Ndërhyrjet kryesore:

- Masat kufizuese qeveritare për të luftuar përhapjen e COVID-19 u shkaktuan nga kapacitetet e ulëta të sistemit të kujdesit shëndetësor dhe besimi i ulët që përfshin marrëdhëniet qytetar-shtet. Ballafaqimi me nivelin e ulët të besimit mund të arrihet vetëm nga një shtet më i përgjegjshëm.
- Lajmet e rreme mund të luftohen nëpërmjet komunikimit të hapur dhe të qartë nga institucionet shtetërore, komunikim ky i udhëhequr nga ekspertët. Risku i synimit të masave represive nuk i prek mediet e rreme, por ato të pavarura dhe kritike.
- Përshkallëzimi i masave të sigurisë dhe kufizimit duhet të përdoret me kujdes dhe në kombinim me edukim dhe komunikim, dhe jo në vend të tyre.

Demokracia dhe kapja e shtetit

Brenda një muaji, rrethanat e krijuara gjatë pandemisë së COVID-19 kanë kontribuar më tej në trendin e përgjithshëm të erozionit demokratik që përmbysi dy dekada të reformave në Ballkanin Perëndimor. Regjimet gjysmë-autoritare në Ballkan kanë shfrytëzuar gjendjen e jashtëzakonshme për të arritur pushtet pothuajse të pakufizuar. Gjendja e jashtëzakonshme krijoi baza të forta për të forcuar më tej regjimet e tyre, të cilat kanë model abuzimi të çdo mundësie për të kapur institucionet demokratike. Burrat e fortë të Ballkanit po e shtrëngojnë më tej kontrollin e tyre të pushtetit dhe kjo situatë mund të zgjasë për një periudhë të pacaktuar kohore.

Masat e jashtëzakonshme të ndërmarra nga qeveritë kundër COVID-19 duhet të jenë të përkohshme dhe me afat të caktuar kohor dhe në përputhje me parimet e demokracisë dhe parimet e sundimit të ligjit. Meqenëse qytetarët e Ballkanit Perëndimor nuk mund të mbështeten në sundimin e ligjit as në rrethana të rregullta, pandemia e COVID-19 është shfrytëzuar nga elitat politike për të minuar më tej standardet demokratike. Kufizimet dhe shkeljet e të drejtave të njeriut, në kundërshtim me dispozitat e Kushtetutës ose ligjeve, ndryshimet legislative me procedura të përshpejtuara, ndryshimet në rregullat zgjedhore, futja e masave drakoniane dhe burgosjet për shkak të postimeve në medie sociale - këto janë vetëm disa nga veprimet qeveritare me qëllim të frikësimit të qytetarëve dhe medie në Ballkanin Perëndimor këtyre ditëve. Për më tepër, partitë politike në pushtet përdorin pandeminë për të testuar kufijtë e pushtetit të tyre ose, më saktë, për zgjerimin e mëtejshëm të tij.

Për të luftuar pandeminë e COVID-19, Serbia dhe Maqedonia e Veriut kanë shpallur gjendjen e jashtëzakonshme, ndërsa të tjerët nuk e kanë ndërmarrë këtë hap, por po zbatojnë masa po aq radikale. Në Serbi, gjendja e jashtëzakonshme u shpall nga Presidenti Vučić, duke e përqendruar kështu pushtetin në duart e presidentit të ndjekur nga një kabinet plotësisht i nënshtruar ndaj tij. Zgjedhjet e planifikuara për 26 prill janë pezulluar - megjithëse kjo ka pasojë të kufizuara, meqë shumica e opozitës kishin vendosur të bojkotojnë zgjedhjet. Zgjedhjet e planifikuara për 12 prill në Maqedoninë e Veriut gjithashtu janë pezulluar, por, ndryshe nga Serbia, gjendja e jashtëzakonshme në Maqedoninë e Veriut u shpall pasi u arrit konsensusi i gjerë ndërmjet të gjitha partive politike relevante.

Kosova është shembulli më i mirë se si pandemia mund të krijojë stuhinë e përsosur për të rrëzuar qeverinë e sapoemëruar. Përkundër faktit se përplasjet ndërmjet kryeministrit Kurti dhe presidentit Thaçi janë të kahershme, debati për gjendjen e jashtëzakonshme që çoi te fuqizimi i figurës së dobësuar të presidentit, shkrepri krizën politike. Kosova shënon rastin e parë ku një qeveri është rrëzuar me votë mosbesimi gjatë pandemisë së COVID-19. Nëse qeveria në detyrë marginalizohet nga presidenti - i cili, me shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme, merr përsipër përgjegjësinë e plotë mbi situatën - ekziston mundësia e një marrëveshjeje Kosovë-Serbi, të lehtësuar nga administrata amerikane dhe të nënshkruar nga dy presidentët,

por që i mungon legjitimiteti më i gjerë demokratik dhe përfshin shkëmbimin e territoreve, me gjithë potencialin për të destabilizuar rajonin.

Shembuj të tjerë të praktikave autokratike dhe të paligjshme janë të shumta. Trupi Koordinues Kombëtar i Qeverisë për Shuarjen e Sëmundjeve Infektive në Mal të Zi publikoi identitetin e personave të urdhëruar të shkojnë në vetë-izolim të detyrueshëm 14-ditor në uebsajtin e qeverisë, vetëm disa ditë pasi filloi zbatimin e masave të shuarjes. Kështu, përveç shkeljes së Kushtetutës dhe Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale,⁷ Qeveria ka mundësuar përdorimin dhe keqpërdorimin e mëtejshëm të të dhënave personale, siç është krijimi i një aplikacioni i cili, bazuar në vendndodhje, mundëson identifikimin e personave në vetë-izolim që ndodhen pranë jush: crnagorakorona.com. Qeveria ka vazhduar gjithashtu disa praktika të kahershme, siç është simulimi i debateve publike për çështje të rëndësishme. Konkretisht, Ministria e Administratës Publike ka shpallur thirrjen për konsultime publike mbi Ligjin për Qasjen e Lirë në Informacion, i cili përfshin dispozita shumë të diskutueshme, në mes të krizës së shkaktuar nga virusi.

Ekziston risku global që masat e jashtëzakonshme të marra në kohë krize përbëjnë ose përpjekje të qëllimshme për të minuar institucionet demokratike, siç shihet në rastin e ligjit të fundit për emergjencë në Hungari, ose risk të paqëllimshëm për të cunuar liritë civile. Masat radikale, duke përfshirë kufizimet e konsiderueshme të demokracisë, ndërhyrjen e shtetit dhe politikat e tjera në dukje të pamundura vetëm disa javë më parë, tani justifikohen si pjesë e luftës kundër pandemisë. Ndërsa luftimi i COVID-19 kërkon masa radikale, të tilla si distanca fizike dhe politikat shtetërore për të siguruar bindjen, këto nuk nënkuptojnë sakrifikim të kontrolleve dhe ekuilibrave demokratikë.

Por, ndërsa është i dëshirueshëm në teori, ky ekuilibër është i vështirë për t'u arritur në praktikë. Për ta luftuar një krizë të jashtëzakonshme, qytetarët mund të jenë të gatshëm të heqin dorë nga liritë e tyre vetëm përkohësisht: mirëpo, problemi është që e përkohshmja shpesh përfundon duke u bërë e përhershme. Kjo tregohet nga fakti se në vitin 2020, gati dy dekada pas

7 "Government to stop publishing personal data of citizens in isolation", Human Rights Action, 23.3.2020, <https://www.hraction.org/2020/03/23/government-to-stop-publishing-personal-data-of-citizens-in-isolation/?lang=en>

sulmeve terroriste të 11 shtatorit, qeveria amerikane ende përdor mjetet e vëzhgimit që u zhvilluan në vazhden e menjëhershme të sulmeve.⁸

Përqendrimi i pushtetit te ekzekutivi në të gjithë rajonin mund të jetë i përkohshëm, por me gjasë efektet do të jenë afatgjata. Së pari, pa një fund të qartë të pandemisë në horizont, kompetencat e jashtëzakonshme mund të shtrihen në mënyrë të konsiderueshme. Së dyti, edhe nëse kjo nuk qëndron, ekziston risku që kriza të përdoret nga ata që janë në pushtet për të konsoliduar fuqinë e tyre dhe për të marginalizuar opozitën tashmë të dobët në disa vende të rajonit. Në fund, disa teknika të kontrollit të qytetarëve që janë futur dhe testuar gjatë gjendjes së jashtëzakonshme mund të mbeten në vend ose të ri-futen lehtësisht në një datë të ardhshme.

Ndërhyrjet kryesore:

- Pandemia nuk mund të jetë justifikim për pezullimin e pakufizuar të demokracisë. Komisioni Evropian (DP për Fqinjësi dhe Zgjerim), do të duhej të nxjerrë udhëzime në bashkëpunim me Këshillin e Evropës, në lidhje me a) cilat kufizime të demokracisë dhe lirive civile janë të pranueshme dhe b) si do të duhej të menaxhohen këto për sa i përket kohëzgjatjes së tyre. Komisioni Evropian do të duhej të monitorojë në mënyrë aktive masat e marra dhe të identifikojë kufizimet problematike dhe të njoftojë qeveritë dhe publikun.
- Për të siguruar monitorim të vazhdueshëm të gjendjes së demokracisë, do të duhej të sigurohen resurse plotësuese për aktorët e shoqërisë civile. Me mbylljen e kufijve, këto resurse të brendshme do të jenë vendimtare për të mundësuar vënien nën llupë të veprimeve të qeverisë dhe abuzimin e pavend të kompetencave të jashtëzakonshme.
- BE-ja do të duhej të përfshijë Ballkanin Perëndimor në përpjekjet e veta për të koordinuar heqjen graduale të kushteve të izolimit. Vëmendje e veçantë do të duhet t'i kushtohet heqjes së shpejtë dhe të plotë për çdo kompetencë ekzekutive padrejtësisht të gjerë, kufizimet e të drejtave civile dhe çdo mbledhje sistematike të të dhënave personale pasi të ketë marrë fund kriza e menjëhershme.

8 Verseek, "COVID19: Rule of Law under Attack in Southeast Europe," Deutsche Welle, 24.3.2020, <https://www.dw.com/en/coronavirus-rule-of-law-under-attack-in-southeast-europe/a-52905150>

Zhvendosjet gjeopolitike

Pandemia e COVID-19 po sfidon rendin global ashtu si e njohim dhe gjithashtu po formon realitet të ri gjeopolitik në Evropë. Ballkani Perëndimor si rajon i rrethuar nga Bashkimi Evropian nuk paraqet përjashtim. Vendet në rajon do të pësojnë humbje të konsiderueshme ekonomike dhe pasoja të rënda sociale. Meqenëse ato mbështeten në tregun e BE-së për eksportin e produkteve të tyre, recesioni i pritshëm në BE do të ndikojë gjithashtu në mirëqenien ekonomike dhe sociale të vendeve në rajon. Shoqëruar me mangësitë ekzistuese të sistemeve të brishta politike, sundimi i pamjaftueshëm i ligjit, tendencat autoritare, liria e diskutueshme e shprehjes dhe e medieve, çështjet e pazgjidhura bilaterale, pasojat ekonomike dhe sociale pas-pandemisë të lartpërmendura mund të shkaktojnë zhvendosje serioze gjeopolitike në rajon.

Zyrtarët e BE-së rregullisht e përshkruajnë BP-në si rajon thelbësor për stabilitetin në Evropë dhe shprehin shqetësimet e tyre lidhur me mundësinë që aktorë të tjerë të huaj potencialisht të mbushin vakumin në oborrin e shtëpisë së BE-së. Për shkak të vendndodhjes gjeografike, lidhjeve të ngushta ekonomike me BE-në, varësisë energjetike nga burimet e jashtme, çështjeve të pazgjidhura bilaterale, institucioneve të dobëta demokratike dhe procesit të gjatë dhe të pasigurt të aderimit në BE, BP-ja tërheq vëmendjen e shumë aktorëve të huaj për arsye të ndryshme.

Kina ka rritur në mënyrë të qëndrueshme praninë e saj ekonomike në BP, ku Serbia zë vend të veçantë në fokusin e saj. Investimet në dukje të pakushtëzuara të Kinës (dhe potenciali për kërkimin e qirasë) janë të njohura. Marrëveshjet bilaterale të investimeve shpesh devijojnë nga standardet e BE-së në lidhje me ndihmën shtetërore, konkurrencën dhe prokurimet, dhe luajnë rol të rëndësishëm, dhe potencialisht në rritje për mbajtjen e elitave qeverisëse në pushtet. Mbështetja kineze është instrumentalizuar në Ballkanin Perëndimor, veçanërisht nga Serbia, si për të kritikuar reagimin e BE-së, ashtu edhe për të justifikuar masat e brendshme bazuar në modelin autoritar të Kinës.⁹

9 Shaun Walker, „Coronavirus diplomacy: how Russia, China and EU vie to win over Serbia,” The Guardian, 13 April 2020. <https://www.theguardian.com/world/2020/apr/13/coronavirus-diplomacy-how-russia-china-and-eu-vie-to-win-over-serbia>

Impakti i diplomacisë së ndihmës dinamike të Kinës gjatë kulmimit të krizës nuk çon medoemos në rritje të ndikimit të saj në Evropë dhe në Ballkanin Perëndimor. Ndërsa presidenti serb Vučić deklaroi se solidariteti evropian është “përrallë” dhe në mënyrë të shkoqur shprehu mirënjohjen e tij për mbështetjen kineze, përafrimi i tillë i ngushtë me Kinën mund të mbetet përjashtim. Një numër i vendeve evropiane që morën ndihma mjekësore kineze vunë re cilësinë e dobët dhe përdorimin e kufizuar të furnizimeve. Për më tepër, dezinformimi agresiv që disa furnizime i futi në kuadrin humanitar kur ato në të vërtetë ishin komerciale, gjithashtu minoi kredibilitetin e pretendimeve kineze. Në fund, BE-ja ka realizuar sfidën gjeopolitike të paraqitur nga Kina nëpërmjet prizmit të pandemisë. Kjo mund të shkrepë reagim më të fortë pas-pandemik.

Ndërsa kostoja ekonomike e pandemisë për Kinën dhe BE-në mbetet e paqartë, ekziston më tej mundësia që Kina të përfshihet më pak në Ballkanin Perëndimor dhe të reduktohet Nisma Një brez, një rrugëe cila mbështet pjesën më të madhe të angazhimit të saj në rajon. Kina ka pranuar perspektivën e anëtarësimit në BE për vendet e BP-së. Nëse lëmë mënjanë emocionet dhe deklaratat publike të afërsisë, realiteti është që interesat afatgjate të Kinës mbeten të përqendruara në tregun e BE-së, jo në tregjet e vogla kombëtare në BP-së. Së këndejmi, diskursi gjeopolitik i BP-së do të duhej të merret parasysh brenda kornizës së marrëdhënieve të ardhshme BE-Kinë.

BE-ja duhet të sigurojë autonominë e vet për të ndjekur interesat e saj të punëve të jashtme dhe të përmirësojë reziliencën në oborrin e shtëpisë së vet kur diskuton me Kinën planet për 5G, projektet e lidhjeve të infrastrukturës, ndryshimet klimatike, shëndetin publik, mbrojtjen e mjedisit dhe politikën e jashtme. Kjo gjithashtu do të kërkojë bashkëpunim më të ngushtë të BE-së me vendet e BP-së në këto fusha. Duke përdorur metodologjinë e saj të zgjerimit që është rishikuar rishtazi, BE-ja do të duhej të gjejë mënyrën për të përfshirë gradualisht vendet e BP-së në planifikimin e saj strategjik, duke i zhvilluar aftësitë e veta të reziliencës gjatë procesit. Kjo është më lehtë të thuhet sesa të bëhet, por krizat kanë ofruar gjithmonë perspektiva të reja se si të adresohen sfidat e përbashkëta.

Në këtë moment, mbase është shumë herët të parashikohet se në cilën rrugë do të kthehet BE-ja. Nuk është për t'u përjashtuar që modeli i Kinës do të bëhet më tërheqës nëse periudha pas pandemisë lejon që popullsitët

të mbizotërojnë në shumicën e shteteve anëtare të BE-së. Në atë rast, vendet e BP-së mund ta gjejnë veten në situatë të vështirë të ballafaqimit me mungesën e mbështetjes që vjen për integrimin e tyre në Bashkimin Evropian dhe të ndjekin tutje rënien e tyre drejt autoritarizmit me bazë populliste. Kostot e perspektivës së tillë autarkike do të ishin të larta si për vendet e BE-së ashtu edhe për vendet e BP-së.

Shtetet anëtare do të duhej ta njohin krizën si shans për të rënë dakord për një vizion të ri që do të duhet të përqafojë parimet themelore të lirisë, demokracisë, të drejtave të njeriut dhe solidaritetit si udhëzues kryesorë të tij. Bashkimi dhe shkëmbimi i resurseve, bashkëpunimi, koordinimi ndërmjet shteteve anëtare të BE-së do të duhet të ketë epërsi ndaj kërkesave të mundshme për ri-nacionalizim, ndarje dhe izolim. BE-ja duhet t'i bazojë politikat e veta në baza reale dhe t'i përshtatë ato me realitetin e marrëdhënieve ndërkombëtare pas pandemisë. Ajo mund të zbulojë interesa të përbashkëta dhe të bashkëpunojë me Kinën në fusha të tilla si tregtia e lirë dhe ndryshimet klimatike, duke mbajtur qasje të rreptë dhe kritike për çështje të tilla si vëzhgimi përmes mjeteve teknologjike, dhe të drejtat e njeriut dhe të pakicave. Vetëm në rast se BE-ja ka për bazë vlera universale dhe është e gatshme t'i mbajë llogaridhënës anëtarët e vet, ajo do të jetë në gjendje të konkurrojë me modelet tjera globale dhe të kërkojë që kandidatët për anëtarësim t'i përmbahen këtyre vlerave të përbashkëta.

Ndërrhyrjet kryesore:

- Si masë e parë, gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor do të duhej të lirohen nga rregullat e fundit të BE-së për pajisjet mjekësore. Gjesti i tillë do të nxjerrë në pah faktin se rajoni nuk përjashtohet nga BE-ja dhe do të demaskojë përpjekjet e disa liderëve rajonalë për të mbështetur braktisjen e rrugës drejt BE-së në favor të partnerëve ndërkombëtarë alternativë, dhe t'i shpërfaqë si akrobaci të marrëdhënieve publike - çka edhe janë.
- BE-ja do të duhej të vazhdojë procesin e integritit të vendeve të BP-së siç është propozuar në metodologjinë e rishikuar të zgjerimit, duke nisur negociatat e anëtarësimit me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut sa më shpejt që të jetë e mundur. Miratimi zyrtar i hapjes së negociatave

përkundër krizës së vazhdueshme të COVID-19 ka dërguar sinjalin e duhur, dhe hapat e ardhshëm duhet të shkojnë në të njëjtin kah.

- BE-ja gjithashtu do të duhej të përfshijë vendet e BP-së në planet e saj të rimëkëmbjes pas pandemisë duke propozuar fonde plotësuese për të zbutur pasojat ekonomike dhe sociale të pandemisë së COVID-19 në vendet e BP-së. Fondi i Solidaritetit i Bashkimit Evropian do të duhej të vihet në dispozicion për të gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor, pavarësisht nga statusi i tyre në procesin e aderimit.
- Çdo plan i mëtutjeshëm i BE-së për të përmirësuar koordinimin në situata të jashtëzakonshme të shkaktuara nga pandemia do të duhej të përfshijë edhe autoritetet e shëndetit publik nga vendet e BP-së. Të gjitha sa u përmendën më sipër do të shërbejnë për të kontribuar në kredibilitetin e integritit në BE për të gjitha vendet e BP-së, ngritjen e profilit publik të mbështetjes nga BE dhe informimin e qytetarëve rreth saj, si dhe mbajtjen e qeverive më llogaridhënëse ndaj retorikës së tyre pro-BE e cila shpesh shmang vëmendjen nga veprimet e tyre populliste.
- Gjithashtu, BE-ja do të duhej të vazhdojë të kërkojë më shumë transparencë në marrëveshjet bilaterale midis vendeve të BP-së dhe kompanive të Kinës, si dhe aplikimin e rregullave të BE-së për prokurimin dhe ndihmën shtetërore të cilat vendet e BP-së janë të detyruara t'i fusin në përdorim gradualisht në përputhje me MSA-të e tyre. Për më tepër, ajo do të duhej të përmirësojë shkëmbimin e informacionit me vendet e BP-së për prokurimin dhe përdorimin e pajisjeve të teknologjisë së lartë nga Kina që mund të përdoren për të kontrolluar qytetarët ose për të rrezikuar lirinë dhe të drejtat e tyre, ose për të minuar sigurinë kibernetike të BE-së (p.sh. 5G, vëzhgimi, dronët).

Nacionalizmat e rinj

Përkufizimi i normalitetit është duke u ridefinuar rrënjësisht në kohën e pandemisë së COVID-19. Ëndrra e çdo nacionalisti për kufij të mbyllur dhe shtete kombëtare për pjesëtarët “e dëlirë” të një komuniteti të përkufizuar në bazë etnike është bërë realitet. Të gjithë kufijtë evropianë në masë të madhe janë të mbyllur për njerëzit që nga mesi i marsit, siç janë edhe pjesa më e madhe e kufijve në Ballkanin Perëndimor.

Në nivel global, ka shumë zëra që paralajmërojnë se përhapja e këtij koronavirusi do të çojë në rritje të nacionalizmit.¹⁰ Emanuel Macron, në fillim të krizës, tha se shtetet e BE-së do të duhej t'i mbajnë të hapur kufijtë aty ku është e mundur dhe të mos i dorëzohen “nacionalizmit” të koronavirusit. Vetëm disa ditë më vonë kjo deklaratë u pasua nga mbyllja e kufijve francezë. Ndërsa është e vështirë të parashikohen pasojat afatgjata, me sa duket pandemia e COVID-19 do të ndihmojë ri-imponimin e rolit të shtetit komb brenda Bashkimit Evropian dhe më gjerë. Mbyllja e shumë prej kufijve ndërmjet vendeve në BE dhe Ballkanit Perëndimor ka ndodhur. Ivan Krastev parashikon që ne do të jemi dëshmitarë të nacionalizmit të forcuar, megjithëse jo nacionalizmit etnik në BE.¹¹ Ndërsa kjo mund të jetë e vërtetë për BE-në, kjo mund të vijë në shprehje ndryshe në Ballkan, me historinë e tij ku nacionalizmi etnik dhe polarizimi nationalist janë të pranishëm gjithandej. Nacionalizmi në Ballkan nuk është rikthyer, sepse asnjëherë nuk është zhdukur nga skena që nga vitet 1990.

Nacionalizmi përjashtues ka qenë ideologji kryesore legjitimuese para krizës dhe pasi të përfundojë kriza, sipas të gjitha gjasave do të kthehet në agjendën e elitave në pushtet. Në afat të shkurtër, kriza mund të shfaqet përmes zbutjes së përdorimit të nacionalizmit meqë si elitat politike ashtu edhe popullsia janë rifokusuar në ballafaqimin me një virus për të cilin nuk mund të fajësohet “etnia tjetër”. Ndonëse jemi dëshmitarë të orvatjeve nga disa popullsi dhe autokratë për t'i fajësuar pakicat, emigrantët apo edhe opozitën (p.sh. në Hungari) për përhapjen e virusit, ose shohim pjesë të

10 Gideon Rachman, “Nationalism is a side effect of the coronavirus,” Financial Times, 23.3.2020, <https://www.ft.com/content/644fd920-6cea-11ea-9bca-bf503995cd6f>, Yuval Noah Harari, “The world after coronavirus,” Financial Times, 20.3.2020, <https://www.ft.com/content/19d90308-6858-11ea-a3c9-1fe6fedcca75>.

11 Iva Krastev, “Seven early lessons from the coronavirus, Views from the Council,” ECFR, 18.3.2020, https://www.ecfr.eu/article/commentary_seven_early_lessons_from_the_coronavirus.

popullsisë që bien pre e teorive të konspiracionit, ne nuk kemi hasur në trendin e fajësimit të “etnisë tjetër” për virusin në Ballkan. Në disa raste, kriza e COVID-19, si simbol i një virusi që dukshëm nuk lidhet me një komb apo grup etnik, gjithashtu ka pasur efekte paradoksale në dinamikën politike në pjesët më të prira për nacionalizëm në Ballkan. Për shembull, në Bosnjë dhe Hercegovinë, qysh në fillim të krizës, Milorad Dodik dhe Dragan Čović dukeshin të vendosur për të vazhduar politikën e tyre për bllokimin e institucioneve shtetërore, dhe të paktën në rastin e Dodik-ut, duke synuar përshkallëzimin e mëtejshëm. Ndërsa kriza filloi të përshkallëzohej dhe Republika Srpska u gjend në situatë jashtëzakonisht të vështirë, ai të paktën ndaloi sulmet e tij të vazhdueshme kundër nivelit shtetëror dhe deklaroi se “politikanët duhet të jenë të bashkuar rreth qëllimit të vetëm për të shpëtuar jetë”. Në fillim të prillit, Izetbegović, Čović dhe Dodik arritën kompromis për të marrë asistencën e shpejtë të FMN-së në kohë të pandemisë.

Por, në planin afatgjatë, meqë legjitimiteti për qeveritë e forta që rrjedhin nga kriza zvogëlohet, është e pashmangshme që ne të jemi dëshmitarë të antagonizmit të rritur dhe kthimit në burimet e vjetra të legjitimitetit. Spiralja rënëse në kuptim të zhvillimit demokratik (me përjashtim të Maqedonisë së Veriut) në Ballkan erdhi paralelisht me ngritjen e re të nacionalizmit (etno) popullist. Megjithatë polarizimi nationalist që i referohet konflikteve të së kaluarës nuk e ka braktisur asnjëherë rajonin, mund të argumentojmë se vitet e fundit, që nga e ashtuquajtura “krizë e refugjatëve” e vitit 2015, kemi parë ngritje mjaft dramatike të polarizimit nationalist (duke përfshirë politikën e zgjatur etno-nacionaliste në Bosnjë dhe Hercegovinë, tensionet ndërmjet Serbisë dhe Kosovës, por kohët e fundit edhe ndërmjet Serbisë dhe Malit të Zi). Me sa duket, ringjallja e nacionalizmit edhe para COVID-19 e ka forcuar frikën si element të rëndësishëm të psikologjisë kolektive të njerëzve. Frika përbën element të rëndësishëm mobilizues të çdo nacionalizmi përjashtues. Frika nga trazirat dhe besimi se vetëm udhëheqja e fortë mund të trajtojë situatën dhe të sigurojë stabilitetin është bërë element i rëndësishëm i psikologjisë kolektive të njerëzve në Ballkan në kohërat e pandemisë së COVID-19. Elitat në pushtet kanë prodhuar koncept të ri të moralizuar të logjikës së përbashkët, sipas të cilit vetëm gjendja e jashtëzakonshme garanton ligjin dhe rendin. Detyra morale “për të bërë gjithçka për ta luftuar koronën” u ofron atyre një mjet shumë funksional të pushtetit për të legjitimuar sundimin e pakufizuar nga normat specifike dhe shteti ligjor. Koronavirusi mund të forcojë marrëdhënien jashtëzakonisht

të ngushtë midis autoritarizmit dhe popullizmit nacionalist në rajon dhe më gjerë, bazuar në një kuptim dikotomik dhe moralist të botës (njerëzit 'e mirë' kundrejt 'të këqij') dhe në tendencën për të kapitalizuar politikisht nga frika e nxitur artificialisht.

Shembull i mrekullueshëm i ndarjeve të rifreskuara politike bazuar në përkatësinë etnike dhe nacionalizmin vjen nga Bosnja kur në ditët e para të krizës, politikanët e HDZ në Kantonin 10 të Federatës, vendosën të parandalojnë të gjithë qytetarët e Bosnjës dhe Hercegovinës që të hyjnë në territorin e kantonit dhe të përhapin infeksionin me COVID-19. Vendimi u tërhoq pas reagimit të ashpër të publikut dhe kritikave.

Një skenë nga faza e parë e krizës së COVID-19 që përfshin Malin e Zi dhe Serbinë gjithashtu ka demonstruar se modelet e vjetra të retorikës nacionaliste dhe tensionet dypalëshe nën sipërfaqe ka të ngjarë të mbeten edhe pas pandemisë. Tensionet dhe retorika e mprehtë ndërmjet dy fqinjëve u rritën në fillim të vitit 2020 pas adoptimit të ligjit të ri për lirinë fetare nga qeveria malazeze. Shpërthimi i pandemisë së COVID-19 ndaloi tensionet për një kohë, vetëm për t'u ndezur përsëri kur Mali i Zi akuzoi Serbinë se kishte konfiskuar tre ventilatorë të dedikuar për Malin e Zi në fund të marsit. Tensionet ka të ngjarë të kthehen pasi të mbarojë pandemia e COVID-19.

Në fund, grupet e cënueshme janë prekur nga diskriminimi për shkak të pandemisë, nga amerikanët-aziatik në Shtetet e Bashkuara deri te emigrantët në Hungari. Romët janë bërë veçanërisht të cënueshëm, meqë shpesh u mungon qasja e barabartë në kujdesin shëndetësor dhe strehimi, gjë që i vë ata në risk më të madh, dhe kanë më shumë gjasa të përballen me masa represive shtetërore dhe diskriminim nga shumica.

Me kufij të mbyllur, është e mundur që të rritet rreziku i autoritarizmit dhe nacionalizmit përjashtues në Ballkanin Perëndimor pas-pandemisë, qoftë me synim kundër shteteve dhe kombeve tjera ose ndaj pakicave brenda vendit.

Ndërhyrjet kryesore:

- Bashkëpunimit rajonal, duke përfshirë Këshillin për Bashkëpunim Rajonal (RCC), do të duhej t'i jepet roli për t'i koordinuar masat në mbarë rajonin dhe për t'i mbajtur të hapura kanalet e komunikimit. Shkëmbimi i praktikave më të mira dhe masat e koordinuara mund të ndihmojnë në parandalimin e ngritjes së konkurrencës.
- Rekomandimet e Komisarit të Lartë të OSBE-së për Pakicat Kombëtare për përgjigjet afatshkurtra ndaj COVID-19 do të duhej të zbatohen në lidhje me pakicat, në mënyrë që të parandalohet vënia e tyre në pozitë të pafavorshme. Kjo bëhet për të parandaluar përshkallëzimin e diskriminimit dhe tensionet e shumicë-pakicë për shkak të përgjigjeve të qeverisë.
- Duhet të merren masa speciale për të mbrojtur pakicat specifike, veçanërisht romët, meqë ata preken më shumë nga pandemia, mungesa e qasjes në kujdesin shëndetësor, diskriminimi dhe stereotipat negativë.

Rezilienca shoqërore

Në shumë aspekte, kriza e COVID-19 ka rritur nivelet e solidaritetit në të gjithë rajonin. Për dallim nga fatkeqësitë e mëparshme të shkaktuara nga njeriu, të gjithë njerëzit në Ballkanin Perëndimor po preken nga një kërcënim që i rrezikon të gjithë dhe nuk është shkaktuar nga të tjerët. Kjo përvojë e përbashkët njerëzore mund të shndërrohet në burim të rëndësishëm solidariteti.

Si kudo tjetër në botë, shumë individë e kanë 'çliruar' kreativitetin e tyre që të shkojë përtej realitetit të vendbanimit të tyre (të paktën ata që janë fatlumë ta kenë një të tillë). Veprimet e solidaritetit kanë marrë shumë forma: nga entuziastët e teknologjisë duke aktivizuar pa pra printerët e tyre 3D për të prodhuar maska mbrojtëse dhe mburoja,¹² deri te profesionistët e shëndetit mendor që ofrojnë ndihmë falas nëpërmjet Facebook-ut¹³, dhe

12 Stojkovski, "Balkan Tech Enthusiasts Deploy 3D Printers against COVID-19." Balkan Insight, 1.4.2020, <https://balkaninsight.com/2020/04/01/balkan-tech-enthusiasts-deploy-3d-printers-against-covid-19/>

13 "TU SMO Balkan" <https://www.facebook.com/groups/tusmobalkan/>

aktorët dhe muzikantët që sjellin artin e tyre te qytetarët e moshuar, që e kanë të pamundur të dalin nga shtëpitë e tyre.¹⁴

Në Ballkan, njerëzit me sa duket e kanë kuptuar shpejt faktin që të mbrosh njëri-tjetrin në mes të pandemisë së COVID-19 do të thotë të mbash distancën. Hija e kohërave të reja, më të rrezikshme mund të ketë ndihmuar në përshtatjen e shpejtë me rrethanat e jashtëzakonshme që kanë ndodhur, përgjithësisht, kudo në rajon. Por, përveç veprimeve që shprehin solidaritetin njerëzor, ka edhe indikacione se kriza mund të shërbejë si katalizator për angazhimin qytetar në nivel më të lartë.

Aksioni “Duartrokitje në 20:00”¹⁵ që krijoi jehonën e gjesteve të ngjashme në mbarë Evropën, të dedikuara fillimisht për punonjësit e kujdesit shëndetësor dhe të organizuara nëpërmjet grupeve të medie sociale, shpejt u shndërrua në manifestim të përditshëm të qëndresës dhe bashkësisë në ballafaqim me vështirësitë. Kur një tërmet i fortë goditi kryeqytetin kroat Zagreb të dielën, më 22 mars, organizatorët reaguesh shpejt për ta ri-dedikuar ngjarjen e asaj dite. Duke ia përkushtuar një duartrokitje të gjatë qytetarëve të goditur nga tërmeti në Zagreb, banorët e Beogradit dhe Sarajevës krijuan urë lidhëse për ndasitë etnike pa u larguar nga shtëpitë e tyre, duke dërguar mesazh shumë më të fortë të pajtimit sesa kishin bërë shumica e politikanëve gjatë tri dekadave të fundit.

Për më tepër, lloji i sjelljes padyshim autoritare që shfaqet nga shumë qeveri në mbarë rajonin ka zgjuar vetëdijen qytetare dhe ka bërë që të bien maskat, duke e zhveshur kështu retorikën boshe.

Nëse ky moment solidariteti dhe zgjimi politik do të mbijetojë krizën, apo do të mbetet një “ishull kalimtar në përmytjen e kohës”¹⁶, mbetet për t’u parë. Gjatë përmytjeve të vitit 2014 që prekën rëndë Kroacinë, Bosnjën dhe Hercegovinën dhe Serbinë, solidariteti trans-nacional ishte i dukshëm, por u shpërbë shpejt meqë elitat politike i zunë frymën angazhimit qytetar, ndërsa angazhimi qytetar nuk arriti të përkthehet në lëvizje më të mëdha sociale për ndryshime.

14 Serbian National Theatre, “Српско Народно Позориште - Serbian National Theatre” <https://www.facebook.com/srpskonarodnopozoriste1861/videos/1350499425150120/>

15 “Aplauz u 8” <https://www.facebook.com/groups/630424531110543/>

16 Andrić, Ivo, “The Bridge on the Drina”, London: Bradford and Dickens, 1962, p. 76.

Sidoqoftë, përdorimi i përmirësuar i teknologjisë si urë lidhëse për ndasitë si dhe organizimi dhe praktika e angazhimit qytetar përtej qyteteve dhe kufijve paraqet pushtim të çmueshëm. Kjo mund të dëshmohej si trashëgimi afatgjatë e kësaj krize.

Ndërhyrjet kryesore:

- Për të shmangur humbjen e hovit aktual të reziliencës qytetare në të gjithë rajonin, është e rëndësishme që krijohet harta e iniciativave të shumta, të freskëta dhe origjinale, të solidaritetit ndërkufitar, ndër-gjenerata dhe ndër-klasë që kanë dalë nga kjo krizë, dhe të verifikohen dinamikat e tyre.
- Nismat qytetare kanë nevojë për ndihmë për të mbijetuar përtej periudhës së mobilizimit fillestar: kjo është po aq e vërtetë nga aspekti financiar, sa është edhe nga aspekti i mbështetjes publike. Shoqëria civile në Ballkan ekziston brenda në një 'hapësirë që tkurret': rrugët në dispozicion të aktivistëve cungohen me tërheqjen e mbështetjes financiare, fushatat e njollosjes në mediet e kontrolluara nga qeveria dhe bashkëpunimi problematik me qeveritë, që përfshin krijimin e 'GONGO'-ve (nga gjuha angleze *Government-Organized Non-Governmental Organization*), përkatësisht OJQ-ve të themeluara nga qeveritë e që nuk janë të pavarura. Ndërsa BE-ja ndihmon shoqërinë civile në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi me fonde nëpërmjet projektit të Asistencës Teknike për Organizatat e Shoqërisë Civile (TACSO 3)¹⁷, mbështetja është dëshmuar të jetë e çmueshme, por e pamjaftueshme.

17 TACSO, "Activities to support civil society during the coronavirus/Covid-19 pandemic", 2020. <https://tacso.eu/activities-to-support-civil-society-during-the-corona-virus-covid-19-pandemic/>

Ndikimi në Mjedis

A është kriza e COVID-19 e mirë për mjedisin? Kjo është një nga pyetjet mbizotëruese këto ditë. Përgjigjja i ka dy aspekte: politik dhe shkencor. Në mbarë botën, shkencëtarët kanë regjistruar rënie të konsiderueshme të ndotjes, veçanërisht nivelet e dioksidit të azotit (NO₂), sipas raporteve të fundit nga NASA.¹⁸

Zhvillimet aktuale janë eksperiment shkencor dhe mjedisor me përmasa globale¹⁹ që nuk do të ishte e mundur të bëhet në rrethana “normale”. Do të ishte e pamundur të arrihet konsensusi ndërmjet shteteve dhe bizneseve për të pezulluar trafikun, industrinë dhe prodhimin e energjisë. Kriza deri më tani na ka mësuar se është e mundur, me zotim dhe fleksibilitet të konsiderueshëm, të ndryshojmë ndjeshëm sjelljet dhe praktikat e punës edhe në nivel personal. Sidoqoftë, ndryshimet e tilla vijnë me kosto të konsiderueshme ekonomike dhe sociale. Përkundër impaktit aktual pozitiv në ndotjen e ajrit, optimizmi lidhur me ndërrimin e kahut të ndryshimeve klimatike duhet të shprehet me kujdes sepse nuk ka asnjë dëshmi të impaktit që kriza e COVID-19 ka në biodiversitetin dhe humbjen e habitateve.

Është me rëndësi të thuhet se ekziston risku thelbësor që prioriteti i politikave që i jepet pandemisë së COVID-19 dhe pasojat e mëvonshme do të shtyjnë çështjet mjedisore dhe ndryshimet klimatike në pjesën e poshtme të agendave të qeverive²⁰. Me fjalë të tjera, kriza ekonomike që buron nga pandemia e COVID-19 do të thotë më pak para për investime qeveritare për mbrojtjen e natyrës. Rivendosja e bizneseve në gjendje të shëndoshë ka të ngjarë të kthejë prapa shpejt këtë bulëz të përkohshme përmirësi.

Kriza e COVID-19 po ekspozon më tej nivelin e emergjencës mjedisore në Ballkan. Gjatë dimrit të kaluar (2019-2020), qytete si Sarajeva, Beogradi,

18 NO₂ është nënprodukt i proceseve industriale, motorëve të makinave dhe termocentraleve dhe ka impakt të rëndë negativ shëndetësor, veçanërisht duke rënduar sëmundjet e frymëmarrjes “Airborne Nitrogen Dioxide Decrease over Italy,” NASA Earth Observatory, 23.3.2020, <https://earthobservatory.nasa.gov/blogs/earthmatters/2020/03/13/airborne-nitrogen-dioxide-decreases-over-italy/>

19 “COVID19 pandemic leading to huge drop in air pollution,” The Guardian, 23.3.2020, <https://www.theguardian.com/environment/2020/mar/23/COVID19-pandemic-leading-to-huge-drop-in-air-pollution>

20 Stephen Stafford & Ben Moore, “Coronavirus: Packham warns of impact on environmental issues,” BBC, 21.3.2020, <https://www.bbc.co.uk/news/uk-england-hampshire-51962578>

Shkupi dhe Prishtina rregullisht ishin në listat e dhjetë qyteteve më të ndotura në botë. Shkaqet e vërteta të niveleve të tilla të larta të ndotjes kanë qenë prej kohësh çështje debati: ekspertët dhe aktivistët kanë alarmuar për impaktin toksik të industrisë së rëndë²¹, por autoritetet shpesh i kanë minimizuar rreziqet e tilla, duke ia atribuar nivelet e larta të ndotjes së ajrit fenomeneve meteorologjike dhe aktiviteteve të drejtuara nga qytetarët.

Por më 27 mars, pas gati dy javë në izolim dhe me trafikun urban në një ndalesë virtuale, Beogradi arriti statusin e zyrtar të qytetit me nivelin më të lartë të ndotjes së ajrit në botë. Ndërsa është e mundur që një stuhi rëre të ketë shtuar ndotjen e ajrit²², as trafiku i makinave as ngrohja shtëpiake në pranverë nuk është e mundur të ishin fajtorët kryesorë. Është e qartë se shkaqet themelore duhet të kërkojnë diku tjetër.

‘Ndotësit e mëdhenj’ janë rrezik i vërtetë në mbarë Ballkanin Perëndimor. Në përgjithësi, termocentralet janë të vjetra, joefikase dhe me cilësi të dobët. Në vitin 2016, 16 termocentralet në rajon që djegin qymyr emetuan më shumë ndotje të dioksidit të sulfurit sesa pjesa tjetër e termocentraleve të qymyrit në Evropë së bashku.²³

Për njerëzit që jetojnë në afërsi të ndotësve të tillë të mëdhenj, kriza e COVID-19 e ka acaruar situatën edhe ashtu të rëndë: COVID-19 dihet se është më vdekjeprurës për ata individë që vuajnë nga sëmundjet e mëparshme, veçanërisht ato që lidhen me sistemin e frymëmarrjes.²⁴ Në shumë vende në mbarë rajonin, ndotja e ajrit industrial mbetet shqetësim më i madh se COVID-19. Më 2 prill, qytetarët në Tuzla (Bosnjë dhe Hercegovinë) nuk iu bindën masave të vetë-izolimit për të protestuar kundër ndërtimit të termocentralit të ri me qymyr në qytetin e tyre që tashmë është i goditur

21 Koalicioni 27, “Chapter 27 in Serbia: Money Talks. Shadow Report on Chapter 27 Environment and Climate Change”, 2019, <http://www.caneurope.org/docman/south-east-europe/3538-money-talks-6th-annual-report-by-serbia-s-coalition-27-environment-climate-change/file>

22 Tomislav Šoštarić, “Zovko: Zagreb Ima Problem, Ali Ne Kao Sarajevo Ili Beograd,” Al Jazeera Balkans, 17.1.2020, <http://balkans.aljazeera.net/vijesti/zovko-zagreb-ima-problem-ali-ne-kao-sarajevo-ili-beograd>

23 Puljic et al., “Chronic Coal Pollution: EU Action on the Western Balkans Will Improve Health and Economies across Europe.”, February 2019.

24 Vasovic, “World’s Worst Air Adds to Serbian Capital’s COVID19 Woes.”, Reuters, 27.3.2020, <https://www.reuters.com/article/us-health-coronavirus-serbia-pollution/worlds-worst-air-adds-to-serbian-capitals-coronavirus-woes-idUSKBN21E2J8?feedType=RSS&feedName=environment> News

fort nga ndotja.²⁵ Aktivistët në Smederevë, qyteti ku gjendet uzina më e madhe e çelikut në Serbi, vazhduan të ekspozojnë situatën e palakmueshme në qytetin e tyre, i cili është i mbuluar me pluhur të kuq dhe ku gjithashtu shpesh bie ‘shiu i kuq’, ndërsa 86% e ujit është i ndotur²⁶.

Me krizën e COVID-19, është bërë e qartë se zhvendosja e fajit për gjendjen e ndotjes së ajrit në Ballkan te veprimet e qytetarëve nuk është më e qëndrueshme. Problemi i rrezikut të madh shëndetësor që paraqet industria e rëndë në Ballkan nuk mund të injorohet më - dhe ka ardhur koha që autoritetet ta adresojnë këtë çështje seriozisht. Mirëpo, impakti ekonomik i pandemisë lë në hije implikimet në lidhje me shëndetin dhe mjedisin. Në përpjekje për të ri-gjallëruar ekonominë në mbarë botën, veçanërisht në rajonet me standarde më të ulëta mjedisore siç është Ballkani Perëndimor, tundimi është i madh për t'i dhënë prioritet rimëkëmbjes së ekonomisë para mjedisit.

Kriza e tanishme është një mundësi që qytetarët të bëhen më të përgjegjshëm ndaj resurseve të tyre natyrore dhe që qeveritë të bëhen më të përkushtuara. Me fjalë të tjera, është e nevojshme të forcohen kapacitetet adaptive në rajon dhe këtë përqendrim në marrëveshje dhe iniciativa rajonale. Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal (RCC) tashmë është i përqendruar në fushën e energjisë dhe mjedisit, dhe kjo është një mundësi për ata që të përshkallëzojnë përpjekjet e tyre ekzistuese.

25 Gerebizza, “Bosnia, La Società Civile Insorge Contro La Centrale a Carbone Targata Intesa.”, Re:Common, 3.2.2020, <https://www.recommon.org/bosnia-societa-civile-contro-centrale-a-carbone-targata-intesa/>

26 Marka Žvaka & Pokret Tvrdjava, Pozdrav Iz Smedereva, 2.4.2020, <https://www.youtube.com/watch?v=gVvHQQIox3Y>

Ndërhyrjet kryesore:

- Duke u nisur nga ndryshimet e shkaktuara nga bllokimet e lidhura me COVID-19, Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal do të duhej të përshkallëzojë e tij për energjinë dhe mjedisin, duke u angazhuar për standarde të përmirësuara në mbarë rajonin dhe duke mbështetur projekte që sjellin përshtatje të qëndrueshme në ato fusha thelbësore.
- Emergjencia e COVID-19 ka zhveshur rrezikun që i kanoset shëndetit të qytetarëve nga termocentralet e mëdha duke përfshirë uzinat e qymyrit, çelikut dhe furnaltat, shumë prej të cilave ende mbështeten në sisteme të vjetruara. Kjo duhet të njihet publikisht nga autoritetet në Ballkanin Perëndimor dhe BE-ja duhet të shtojë presionin e saj për të siguruar respektimin e standardeve shëndetësore dhe mjedisore, me vëmendje të veçantë për industrinë e rëndë.

Migrimi dhe shëndetësia

COVID-19 ka ekspozuar seriozitetin e emigrimit masiv të punonjësve shëndetësorë nga Ballkani Perëndimor dhe sa e rëndësishme është të mbash personelin mjekësor në vend. Pandemia gjithashtu zbuloi dobësitë sistimore të sistemit shëndetësor, pasojë e investimeve të pakta gjatë disa dekadave në njerëz, objekte dhe pajisje. Në fund, ajo shpalosi plotësisht mungesën e investimeve gjatë disa dekadave nga vendet e Ballkanit Perëndimor në arsim, shkencë dhe kërkim e zhvillim. Mesatarisht, këto vende shpenzojnë më pak se 0.4 për qind të BPV-së për kërkim e zhvillim.²⁷

Nuk është sekret se para pandemisë, mijëra punonjës shëndetësorë, përfshirë mjekë, infermierë, staf teknik dhe kujdestarë mjekësorë u larguan nga rajoni i Ballkanit Perëndimor vit pas viti. Në Bosnjë dhe Hercegovinë, shoqata kombëtare e punonjësve mjekësorë raportoi se rreth 300 mjekë me kualifikime të larta ishin larguar nga vendi në vitin 2016.²⁸ Në shtator

27 Support to the Higher Education Reform Experts (SPHERE), Harnessing the potential: Research Capacity in the Western Balkans, December 2017, https://supportthere.org/sites/default/files/western_balkan_report_final_-_2018_07_02.pdf

28 Alida Vracic, The Way Back: Brain Drain and Prosperity in the Western Balkans, ECFR, 9.5.2018, https://www.ecfr.eu/publications/summary/the_way_back_brain_drain_and_prosperity_in_the_western_balkans.

2019, spitali kantonal në Zenica, Bosnjë dhe Hercegovinë, nxori komunikatë publike duke specifikuar se ky qytet me mbi 100,000 banorë nuk ka më në dispozicion kujdes mjekësor neuro-pediatrik. Në kohën kur u bë ky njoftim, një numër i madh i fëmijëve kishin kontrolle të caktuara, gjë që rezultoi me shtyrje të këtyre ekzaminimeve deri në njoftimin e radhës. Pasojat e eksodit të punonjësve shëndetësorë janë shumë të dukshme në terren, duke çuar në nën-zhvillim sektorial, i cili është veçanërisht i dukshëm në rajonet periferike dhe në radhët e të moshuarve, fëmijëve dhe grave. Kjo prek kapacitetet e sistemeve shëndetësore, duke i shtyrë ato drejt pikës së rrënimit, por gjithashtu rezulton në humbjen e shërbimeve shëndetësore, rënien e cilësisë së kujdesit shëndetësor, humbjen e mentorimit, kërkimit dhe mbikëqyrjes. Sipas Politico, 10% e popullsisë së Rumanisë tani jetojnë pa kujdes shëndetësor, për shkak të emigrimit të punonjësve shëndetësorë.²⁹

Ikja e mjekëve për në Perëndim viteve të fundit është dokumentuar në çdo vend ish-socialist në Evropën Juglindore dhe në Ballkan. Me mijëra mjekë, nga Polonia deri në Bullgari dhe në të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor, po largohen nga vendet e tyre.

Ndërmjet qershorit 2013 dhe marsit 2016, rreth 4,213 boshnjakë gjetën punë në sektorin gjerman të kujdesit shëndetësor, duke e çuar shifrën e përgjithshme të boshnjakëve të punësuar në këtë sektor në Gjermani në 10,726. Të dhënat e Agjencisë Gjermane të Punësimit tregojnë gjithashtu se në mars 2016, në Gjermani ishin punësuar 1,102 mjekë boshnjakë, që paraqet rritje prej 20% gjatë periudhës nga qershori 2013 deri në mars 2016. Vitet e fundit këto shifra u rritën vullshëm dhe vlerësohet se për çdo gjashtë mjekë në Bosnjë, një punonjës tani në Gjermani.³⁰ Këshilli Kombëtar Mjekësor i Serbisë ka lëshuar rreth 800 vërtetime të rregullsisë brenda një viti - dokument që i nevojitet mjekëve kur aplikojnë për punë jashtë vendit.³¹

29 Ginger Hervey, "The EU Exodus: When Doctors and Nurses Follow the Money," Politico, 27.9.2017, <https://www.politico.eu/article/doctors-nurses-migration-health-care-crisis-workers-follow-the-money-european-commission-data/>.

30 Katarina Panic and Danijela Kozina, "Germany Drains Bosnia of Doctors and Nurses," Balkan Insight, 23.12.2016, <https://balkaninsight.com/2016/12/23/germany-drains-bosnia-of-doctors-and-nurses-12-21-2016/>.

31 Beogradski glas, Iseljenje sanja 75 odsto lekara: U narednim godinama odlazak zdravstvenih radnika mogao bi da ugrozi sistem zdravstvene zaštite, 2018. Në dispozicion në: <http://beogradski-glas.rs/drustvo/iseljenje-sanja-75-odsto-lekara-narednim-godinama-odlazak-zdravstvenih-radnika-moglo-da-ugrozi-sistem-zdravstvene-zastite/>.

Arsyet kryesore përfshijnë çështjet e mungesës së profesionalizmit në vendin e punës, kompensimin e pamjaftueshëm dhe kushtet e dobëta të punës. Pagat mujore për mjekët në Qendrën Klinike Universitare në Prishtinë, që është spitali më i madh në Kosovë, janë gjithsej vetëm 632 EUR për mjekët dhe 403 EUR për infermierët. Sipas fjalëve të Harun Drljević, kryetar i Këshillit Kombëtar Mjekësor të Federatës Boshnjake, “Vendet e BE-së po marrin mjekë ‘të gatshëm’ pa investuar asgjë në arsimin dhe trajnimin e tyre. Të gatshëm dhe falas! Kjo është dhuratë e shkëlqyeshme për sistemet shëndetësore të vendeve të BE-së.”³²

Ky problem është njohur deri diku në nivel të BE-së, por, në të njëjtën kohë, BE-ja përfiton shumë nga ky emigrim. Gjermania, ekonomia më e pasur e BE-së, është ndër përfituesit më të mëdhenj të këtij trendi dhe josh në mënyrë aktive mijëra individë me kualifikime të larta me vende pune në Gjermani, ndërsa Kosova, Maqedonia e Veriut, Bosnja, Filipinet dhe Kuba rregullisht renditen si vende partnere të mundshme për bashkëpunim.

Ndërhyrjet kryesore:

- Ofrimi i kornizës gjithëpërfshirëse për migrimin qarkor të personelit mjekësor të specializuar. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për vendet më të vogla me shkallë më të lartë të emigrimit të punëtorëve të kualifikuar dhe me më pak mundësi për t’i zëvendësuar ata shpejt.
- Duke lejuar bartjen e përfitimeve nga vendi në vend, trajnime plotësuese dhe specializime, por gjithashtu duke siguruar që kualifikimet e fituara jashtë vendit njihen dhe vlerësohen në vendin amë, qeveritë mund të ndryshojnë rrënjësisht dinamikën e punës dhe emigrimit brenda një shoqërie.
- Krijimi i portaleve elektronike globale kombëtare për të përfshirë të gjithë individët që përbëjnë diasporën dhe organizatat që lidhen me diasporën do të mundësonte shkëmbimin e njohurive dhe përvojave.
- Relaksimi i ligjeve të emigrimit dhe lejimi i integrit të të huajve në rajon. Aktualisht, shqetësimi në rritje për çështjet sociale që lidhen me emigrimin përcakton politikat kombëtare për këtë çështje.

32 Panic, Kozina, “Germany Drains Bosnia of Doctors and Nurses.”

- Duke pasur parasysh numrin e stafit mjekësor nga Ballkani Perëndimor në BE, BE-ja do të duhej të krijojë programe të fuqishme shkëmbimi me institucionet e shkencave mjekësore në vendet e rajonit - duke i ofruar të dy palëve fleksibilitet më të madh. Qasja e tillë mund të sjellë përfitimin e rritjes së regjistrimit në degët dhe sektorët arsimorë të profesioneve me vlerë të madhe në rajon.

Politikat shëndetësore dhe mbrojtja sociale

Reagimi i fortë ndaj pandemisë nga qeveritë doli si domosdo e vetëdijes për dobësinë relative të sistemeve shëndetësore në rajon dhe që këto sisteme do të mposhten fare shpejt nëse shkalla e infeksionit del jashtë dore, veçanërisht duke pasur parasysh popullsinë relativisht të moshuar në disa prej vendeve.

Kriza gjithashtu do të ekspozojë mangësitë në ofrimin e mbrojtjes sociale në të gjithë rajonin. Sistemet e kujdesit shëndetësor janë më pak të zhvilluara sesa në BE, dhe rritja e vullshme e rasteve të COVID-19 fare lehtë mund të mposhtë sistemet e kufizuara. Kujdesi shëndetësor operon në një ekonomi të dyfishtë, ku sektori publik i shëndetësisë ka pak fonde dhe është i pa-pajisur, kurse sektori privat ka resurse të mira dhe kujdeset për grupet elitare socio-ekonomike. Ndërsa ky sistem arrin të përmbushë nevojat themelore në kohëra normale, sistemi publik në veçanti mund ta ketë jashtëzakonisht të vështirë të përballët me një rritje të rasteve të COVID-19. Pjesëtarët e grupeve të cënueshme, siç janë romët, që shpesh nuk e kanë librezën e sigurimeve shëndetësore sociale, shërbejnë dobët nga sistemi publik i kujdesit shëndetësor edhe në kohërat më të mira. Janë marrë masa të kufizuara për të rritur kapacitetin e sektorëve shëndetësor në mbarë rajonin. Në Shqipëri, janë siguruar fonde shtesë për sektorin e shëndetësisë që arrijnë në 3.5 miliardë lekë (1 milion dollarë) për të blerë pajisje mbrojtëse personale (PPE) për punonjësit e kujdesit shëndetësor. Bonuse prej 1,000€ janë shtuar në pagat e stafit mjekësor, dhe 500€ në pagat e punonjësve mjekësorë. Më 10 mars, presidenti Ilir Meta i bëri thirrje mjekëve shqiptarë në pension që të rikthehen në forcën e punës. Kapaciteti i spitaleve privat është marrë përsipër, ku në rast të mosbindjes shqiptohet gjobë prej 40,000€. Bosnja dhe Hercegovina: Federata do t'ia transferojë 30 milionë KM (0,1 për qind të BPV-së) spitaleve. Republika Srpska ka njoftuar se fondi shëndetësor do të mbulojë kostot e kujdesit shëndetësor për të

gjithë pacientët. Në Kosovë, qeveria ka ndarë 6 milionë € për Ministrinë e Shëndetësisë. Në Serbi, qeveria ka shpallur rritje prej 10 për qind të pagave (rikthimi në gjendjen para uljes nga masat shtrënguese) dhe rritje të shpenzimeve për sektorin publik të kujdesit shëndetësor prej 12 miliardë dinarë. Ndiurma ndërkombëtare gjithashtu është vënë në dispozicion për rajonin, kryesisht përmes një rregulloreje të BE-së që shtrin fushëveprimin e Fondit të Solidaritetit të BE-së për shtetet që aderojnë për emergjencë madhore të shëndetit publik dhe fatkeqësi të tjera. BE-ja ka ndarë 38 milionë € në mbështetje të menjëhershme për Ballkanin Perëndimor për të trajtuar emergjencën shëndetësore të shkaktuar nga pandemia. Për shembull, BE-ja njoftoi ndarjen e ndihmës për Bosnjë dhe Hercegovinën në vlerë prej 7 milionë € (23 mars) për të blerë pajisje mjekësore, duke përfshirë 80 ventilatorë, 7,500 takëme testimi dhe 15,000 artikuj të PPE. BE-ja gjithashtu ka rialokuar 374 milionë € të fondeve nga IPA për të mbështetur rimëkëmbjen socio-ekonomike në rajon. Mirëpo, në Serbi, më shumë rëndësi i është kushtuar ndihmës nga aktorët e tjerë ndërkombëtarë. Shumë publicitet i është dhënë donacionit rus me 15,000 takëme testimi, donacionit nga Emiratet e Bashkuara Arabe prej 10 tonë ndihmë mjekësore, dhe donacionit nga Norvegjia prej 5 milionë € ndihmë. Në rastin më dramatik, Kina dërgoi një ekip ekspertësh mjekësorë nga Wuhan-i së bashku me ventilatorë, maska dhe 1,000 takëme testimi.

Përveç dobësive në sistemin e kujdesit shëndetësor, sistemet e mbrojtjes sociale janë të papërgatitura për t'i dalë ndesh emergjencave për shkak të nivelit të ulët të përfitimeve sociale monetare për grupet e cënueshme dhe ofrimit të pamjaftueshëm të shërbimeve sociale. Vendet e rajonit janë përgjigjur ndaj krizës duke bërë përmirësime të vogla në sistemet e tyre të mbrojtjes sociale. Në Shqipëri, pensionistët do të fillojnë të marrin pensionet e tyre në shtëpi me postë, ndërsa kamatë-vonesat për faturat e energjisë elektrike janë hequr. Përfitimet e papunësisë dhe pagesa të ndihmës sociale janë dyfishuar, dhe 2 miliardë lekë shpenzime të mbrojtjes janë ri-destinuar si ndihmë humanitare për më të cënuarit. Në Kosovë, qeveria ka bërë paraprakisht pagesat nga skemat e ndihmës sociale duke shtuar një muaj plus pagesë për të mbështetur familjet nevojtare. Në Mal të Zi, 1 milion euro ndihmë financiare janë ndarë për pensionistët me të ardhura të ulëta dhe përfituesit e skemave të mbrojtjes sociale, ekuivalente me një pagesë prej 50€ për secilin. Në Serbi, një pagesë e një-hershme do të bëhet për të gjithë pensionistët (gjithsej 7 miliardë dinarë), dhe gjithashtu

është paralajmëruar pagesa e një-hershme prej €100 për të gjithë qytetarët. Në përgjithësi, ndryshimet e paralajmëruara në sistemin e mbrojtjes sociale janë tejet të pamjaftueshme për të zëvendësuar humbjet e fitimit për shkak të mbylljes në shtëpi, orës policore dhe humbjes së vendeve të punës. Recesioni i pritshëm ka të ngjarë të shkaktojë humbjen e mijëra vendeve të punës. Në Serbi, megjithëse nuk ka informacione zyrtare, burimet nga sindikatat vlerësojnë se rreth 10,000 vende pune tashmë janë humbur për shkak të mbylljes së uzinave. Do të jetë i nevojshëm një përmirësim thelbësor i përfitimeve të papunësisë dhe pagesave nga skemat e mbrojtjes sociale, veçanërisht në lidhje me përshtatshmërinë e pagesave për pushim mjekësor, për ta trajtuar këtë krizë dhe për të siguruar paqen sociale.

Pas krizës ekonomike të vitit 2008/9, qeveritë e rajonit rritën shpenzimet e tyre publike për të krijuar vende pune në sektorin publik dhe për të shpërblyer përkrahësit e tyre me anë të masave për mbështetje të të ardhurave dhe përfitimeve kategorike. Meqenëse skemat e shpëtimit të FMN-së u krijuan në mes të dekadës, ulja e borxhit dhe konsolidimi fiskal ka drejtuar qasjen nga aspekti i politikës. Nëse politika të tilla shtrënguese do të vazhdonin gjatë periudhës së pandemisë së COVID-19, pasojat sociale mund të jenë shumë më të rënda në krahasim me krizën e mëparshme ekonomike, dhe kundërshtimi i mundshëm politik ndaj politikave të tilla mund të jetë substancial.

Ndërhyrjet kryesore:

- Të ardhura themelore universale të përkohshme, përgjatë vijave të pagesës së një-hershme prej 100€ për secilin qytetar të paralajmëruara në Serbi, duke u siguruar të gjithë qytetarëve të moshës madhore në rajon një pagesë ekuivalente me 50% të pagës minimale pavarësisht nga statusi i punësimit, së bashku me 25% të pagës minimale e pagueshme për secilin fëmijë deri në moshën 18 vjeç. Kjo do të duhej të zbatohet për një periudhë prej 3 muajsh të krijuar për të mbështetur kërkesën e përgjithshme e cila përndryshe mund të pësojë rënie të thiktë. Nëse do të shtrihet përtej kësaj pike, një riorganizim i sistemeve tatimore për t'i bërë më progresive tatimet mbi të ardhurat, në mënyrë që përfitimet universale të mund të paguheshin nga tatimet në vend se nga huamarrja.

- Do të duhej të futet një dispozitë për të ardhura pa tatim për ata që fitojnë pak dhe normë më e lartë e tatimit për ata që fitojnë të ardhura më të larta, në vend të sistemeve tatimore të sheshta ose proporcionale të zakonshme në mbarë rajonin.
- Megjithëse numri i shtretërve spitalorë është adekuat, resurset do të duhej të përqendrohen në përmirësimin e cilësisë së pajisjeve spitalore, sigurimin e furnizimeve adekuate me barna dhe uljen e mbipopullimit në repartet spitalore për trajtim akut, së bashku me rritjen e pagave për stafin spitalor për të siguruar mbajtjen e tyre në vend të punës, të gjitha këto të dizajnuara për t'i afruar standardet në sistemin publik të kujdesit shëndetësor më afër nivelit të sektorit privat të kujdesit shëndetësor në rajon.
- Qasja e grupeve të cënueshme, siç është popullata rome, në ofrimin e kujdesit shëndetësor do të duhej të jetë prioritet.
- Shtrirja e mbrojtjes sociale për shumë punëtorë që janë të angazhuar në sektorin joformal gjithashtu do të duhet të përcaktohet si prioritet, dhe do të nevojitet një rishikim i madh lidhur me trajtimin e ekonomisë joformale që është shumë e përhapur.


Ndikimi Ekonomik në Ballkanin

Vendet e Ballkanit Perëndimor janë rimëkëmbur vetëm tash rishtas nga efektet shpërndarëse të krizës së eurozonës dhe kanë regjistruar rritje të fortë ekonomike gjatë viteve të fundit. Pjesërisht, kjo është bazuar në fluksin e ri investimeve të huaja, veçanërisht në Serbi dhe Maqedoninë e Veriut, në industrinë e prodhimit dhe përpunimit, duke krijuar mijëra vende të reja pune. Pandemia e COVID-19 bëri që kjo rimëkëmbje të ndalet në vend, me recesion të parashikuar për vitin 2020, mbase ekuivalent me rënie të BPV-së prej 3-5%. Edhe pse politikat e brendshme kanë qenë relativisht të suksesshme deri më tani, nuk ka gjasë që ato të mbrojnë ekonominë e rajonit nga pasojat ekonomike, meqë këto varen shumë nga fatkeqësitë ekonomike të BE-së dhe recesioni, i cili është veçanërisht i mundshëm në Itali ku impakti i krizës ka qenë më i rëndë.

Impakti global, si dhe ai në Ballkanin Perëndimor, përcaktohet nga dy faktorë. Së pari, kapaciteti i sistemeve shëndetësore për përballim, dhe së

dyti, gjendja e financave publike të vendeve (dhe për këtë arsye aftësia e tyre për të mbështetur punonjësit dhe firmat gjatë tatëpjetës).

Në të dyja pikat, perspektivat e Ballkanit Perëndimor nuk janë shumë premtuese. Madje edhe të përshtatura për kostot lokale, shpenzimet e kujdesit shëndetësor në sektorin publik për frymë janë mesatarisht 15% e nivelit gjerman (dhe vetëm rreth një e treta e nivelit të vendeve të pasura të EQL, siç është Sllovenia). Si rezultat, edhe pse numri i rasteve nuk rritet aq shpejt sa në shumë vende të tjera³³ (shih grafikun më poshtë), qeveritë e Ballkanit Perëndimor janë përcaktuar për të kufizuar në mënyrë të ashpër jetën ekonomike (më shumë sesa në shumë pjesë të tjera të EQLJL).³⁴



Grafiku 1

33 WIIW përdor katër vende krahasuese për të matur përhapjen e virusit, që pasqyrojnë lloje të dallueshme të përgjigjeve: Italia, Koreja e Jugut, Suedia dhe Singapori.

34 WIIW, "Eastern Europe Coronavirus tracker: Preparing for the worst," 31.3.2020, <https://wiiw.ac.at/eastern-europe-COVID19-tracker-preparing-for-the-worst-n-430.html>

Ndërkohë, hapësira për manovrim fiskal ka gjasë të jetë shumë e kufizuar. Vendet e Ballkanit Perëndimor po futen në krizë me raporte borxh publik/BPV konsiderueshëm më të larta në krahasim me vitin 2007 (mesatarisht 22 pp), dhe bankat qendrore në rajon nuk do të jenë në gjendje të absorbojnë shumën të mëdha të borxhit qeveritar si ato në Evropën Perëndimore. Kjo reflektohet në planet aktuale të stimulimit fiskal, të cilat në përgjithësi janë më të modeste sesa edhe në pjesën më të madhe të vendeve në EQL.

Impakti i pandemisë së COVID-19 në punësim dhe paga do të jetë më i madh se sa pas krizës globale financiare të vitit 2008. Rënia e dërgesave do të ketë impakt negativ në disa vende të rajonit sa i përket flukseve hyrëse të dërgesave (të cilat përbëjnë rreth 10% të BPV-së në Bosnjë dhe Hercegovinë, Shqipëri dhe Mal të Zi, dhe mbi 15% në Kosovë, sipas të dhënave nga Banka Botërore), ndërsa punëtorët migrantë nga rajoni humbasin vendet e tyre të punës në mbarë BE-në. Mund të pritët rënia e të hyrave nga eksporti meqë kërkesa e BE-së për mallra dhe shërbime nga vendet e Ballkanit ka të ngjarë të zvogëlohet, dhe meqë zinxhirët e furnizimit të prodhimit do të çrregullohen nëse kompanitë shumëkombëshe të vendosura në rajon mbyllin operacionet e tyre. Ky proces tashmë ka filluar, veçanërisht në fabrikën e Fiat-it në Serbi që mbylli operacionet në shkurt për shkak të mungesës së komponentëve kritikë nga Kina për prodhimin në fabrikën e automjeteve në Kragujevc. Për më tepër, do të ketë rënie substanciale të numrit të turistëve (veçanërisht në Mal të Zi dhe Shqipëri, ku turizmi dhe udhëtimi përbëjnë rreth një të pestën e ekonomisë) dhe kërkesa e brendshme do të dërmohet për të paktën dy muaj.

Si një skenar bërthamor, ne supozojmë që jeta ekonomike do të kufizohet rëndë për 2-3 muaj, dhe se do të ketë të paktën izolime të pjesshme derisa të fillojë vaksinimi masiv pas 12-18 muaj. Në kuptim të rënies së BPV-së, punësimit dhe pagave (BPV-ja reale mund të tkurret me rreth 3-5% këtë vit në mbarë Ballkanin Perëndimor), viti 2020 do të jetë më i keq se viti 2009. Viti vijues do të jetë gjithashtu i vështirë, por rimëkëmbja do të duhej të arrijë në gjysmën e dytë të vitit 2021, dhe kushtet ekonomike dhe sociale do të përmirësohen ndjeshëm në vitin 2022.

Një skenar më pozitiv do të përfshinte tri gjëra kryesore. Së pari, një paketë masive e stimulimit fiskal e koordinuar në eurozonë, me efekte shpërndarëse materiale pozitive për Ballkanin Perëndimor. Së dyti, të gjitha vendet do të merrnin gjithashtu ndihmë të konsiderueshme të huaj (pa kushte

shtrënguese), duke lejuar disa masa të kufizuara për stimulim ekonomik të brendshëm. Së treti, do të duhej të bëhet testimi masiv sa më shpejt në të gjithë rajonin, duke lejuar kthim më të shpejtë në një shkallë më të lartë të jetës normale ekonomike. Këtu, ne presim vetëm tkurrije të vogla vjetore të BPV-së në vitin 2020, përpara rimëkëmbjes së denjë në vitin 2021.

Sipas skenarit tonë negativ, një rënie e thellë gjatë këtij viti do të bëjë që shumë biznese të dështojnë. Kombinuar me nivele shumë të larta të papunësisë, kjo çon në mospërmbushje masive të borxheve, dhe e shndërron krizën aktuale shëndetësore në krizë financiare. Kjo jo vetëm që do të nënkuptojë rënie të thellë në vitin 2020 (me tkurrije të BPV-së reale prej potencialisht 5-10% këtë vit, dhe vështirësi të mëdha për shumicën e popullatës), kjo gjithashtu do të nënkuptojë impakt shumë më të gjatë (si pas vitit 2008), me papunësi të lartë, paga të ulëta dhe rritje të papërfillshme të BPV-së për disa vjet.

Ndërhyrjet kryesore:

- Qeveritë do të duhej të ofrojnë mbështetje të likuiditetit për NVM-të (firmat më të mëdha do të duhej të kenë të paktën ca rezerva të parasë së gatshme).
- Qeveritë duhet të organizojnë furnizimin dhe shpërndarjen e ushqimit për të varfrit dhe të moshuarit.
- Do të duhej të merren masa për të mbështetur emigrantët që kthehen, veçanërisht ata që kanë humbur vendet e punës në BE dhe ata që u kthyen gjatë fazës fillestare të pandemisë.
- Të gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor duhet të përfshihen në mekanizmat e asistencës së BE-së për trajtimin e impaktit ekonomik të pandemisë.

Konkluzion

Ballafaqimi me pandeminë globale nuk është vrap i shpejtë në 100 metra, por maratonë. Qeveritë dhe organizatat ndërkombëtare, si edhe qytetarët, janë në fazën e hershme të ballafaqimit me sfidat e shumta të shkaktuara nga pandemia. Më e rëndësishmja, ekziston nevoja për të parandaluar përhapjen e COVID-19. Në veçanti në Ballkanin Perëndimor, me sisteme të brishta të kujdesit shëndetësor dhe me numër të kufizuar të personelit mjekësor, nevoja për të mbajtur numrin e infeksioneve në shkallë të ulët është mbi të gjitha. Sidoqoftë, masat tejet kufizuese duhet të jenë proporcionale dhe të merren duke pasur parasysh nevojën e ballafaqimit me pandeminë për më gjatë sesa vetëm disa javë. Gjetja e normalitetit dhe jetesa me pandeminë derisa të gjendet trajtimi kërkon masa me të cilat mund të jetojnë banorët e Ballkanit Perëndimor, pa çuar në tendosje të panevojshme ekonomike, sociale dhe psikologjike. Përveç kësaj, masat duhet të kalibrohen me kujdes për të mos rrezikuar demokracitë tashmë të brishta dhe për të mos thelluar kapjen e shtetit në të gjithë rajonin. Së këndejmi, kufizimet në rregullat demokratike dhe liritë civile duhet të jenë proporcionale, të komunikohen hapur dhe në mënyrë transparente me përfshirjen e sa më shumë aktorëve politikë. Në fund, ato duhet të jenë të përkohshme, me afate të qarta të skadimit të tyre. Liria e fjalës dhe puna e institucioneve, përfshirë parlamentin dhe gjykatat me proces të rregullt, duhet të ruhen.

Parandalimi i polarizimit dhe tensioneve të reja kërkon bashkëpunim më të madh rajonal dhe koordinim të masave shtetërore dhe BE-ja duhet të përshkallëzojë ndihmën e saj dhe të përfshijë rajonin në planifikimin për rindërtimin pas COVID-19. Për të mos u dhënë shansin aktorëve të tjerë gjeopolitikë që të rrëmbejnë rajonin gjatë krizës, BE-ja duhet ta komunikojë ndihmën e saj në mënyrë të qartë dhe të fortë, dhe t'i kundërvihet dezinformatave. Kriza ka zbuluar natyrën e thyeshme të kontratës sociale në rajon; prandaj, solidariteti dhe përvojat e përbashkëta mund të ndihmojnë në epokën pas COVID-19.

Ndërsa ekonomitë e rajonit do të goditen rëndë, duke filluar nga emigrantët që humbën vendet e tyre të punës në ekonomitë formale dhe joformale të BE-së, mbyllja e prodhimit për shkak se kërkesa ka marrë tatëpjetën, deri te sektori i turizmit - do të duhen vite për t'u rimëkëmbur. Ndërhyrja e shpejtë

mund të ndihmojë në kapërcimin e disa prej pasojave më të këqija, por pasojat sociale dhe ekonomike do të jenë veçanërisht të vështira për grupet e cënueshme.

Në tërësi, është e vështirë të vlerësohen pasojat e pandemisë dhe pasojat e përgjigjeve të qeverisë ndaj pandemisë. Për shkak të tyre, shumë njerëz në Ballkanin Perëndimor do të gjenden në pozitë më të vështirë. Shoqëritë dhe shtetet shpesh janë ndjerë të cënueshme dhe të brishta. Nëse kjo situatë analizohet me kujdes për të gjetur shkaqet e brishtësisë përtej pandemisë, ajo mund të çojë deri te rindërtimi me synim dhe krijimi i shteteve dhe shoqërive më reziliente. Nëse në vend të kësaj, kriza dhe përgjigjet përshpejtojnë trendet që formuan pjesë të mëdha të rajonit para krizës, përfshirë rënien demokratike, kapjen e shtetit dhe institucionet e dobëta, pasojat mund ta kthejnë rajonin prapa për vite të tëra.

Rreth Fondit Evropian për Ballkanin

Fondi Evropian për Ballkanin është iniciativë e përbashkët e disa fondacioneve evropiane (Fondacioni Erste, Fondacioni Robert Bosch dhe Fondacioni King Baudouin) që parashikon, drejton dhe mbështet nisma që synojnë forcimin e demokracisë, nxitjen e integritimit evropian dhe afirmimin e rolit të Ballkanit Perëndimor në adresimin e sfidave të sapo dala në Evropë. Strategjia e azhurnuar e programit përqendrohet në tri fusha ombrellë - nxitja e demokratizimit, forcimi i bashkëpunimit rajonal dhe rritja e integritimit në BE.

Duke implementuar projekte, nisma dhe aktivitete të ndryshme, Fondi mbështet procesin e afirmimit të kredibilitetit politik të politikës së zgjerimit në mbarë rajonin e Ballkanit Perëndimor, duke përmirësuar bashkëpunimin rajonal në radhët e shoqërisë civile në rajonin e BP-së bazuar në solidaritet dhe dialog të drejtuar nga kërkesa, si dhe duke ofruar mjete dhe platforma ku qytetarët e informuar dhe të fuqizuar do të ndërmarrin veprime dhe do të kërkojnë institucione llogaridhënëse dhe demokraci. Efektet e tyre sinergjetike përqendrohen në reformat e vazhdueshme të politikave dhe praktikave të vendeve të Ballkanit Perëndimor në rrugën e tyre drejt aderimit në BE, nëpërmjet bashkimit të ngritjes së kapaciteteve sociale të rajonit me zhvillimin e platformës së politikave, dhe në frymën e kulturës së bashkëpunimit rajonal.

Kontakti: ALEKSANDRA TOMANIĆ, Drejtore ekzekutive, Fondi Evropian për Ballkanin, aleksandra.tomanic@balkanfund.org, +381 (0) 11 3239 877, European Fund for the Balkans, Majke Jevrosime 20, 11 000 Belgrade, Serbia, www.balkanfund.org

Rreth Qendrës për Studime të Evropës Juglindore, Universiteti i Graz-it

Qendra për Studime të Evropës Juglindore u themelua në nëntor 2008 pas përcaktimit të Evropës Juglindore si prioritet strategjik në Universitetin e Graz-it në 2000. Qendra është institucion për kërkime dhe arsimim ndërdisiplinor dhe ndër-universitar, e themeluar me qëllimin për të ofruar hapësirë për aktivitete të begatshme mësimore dhe kërkimore në universitet mbi dhe me Evropën Juglindore dhe për të promovuar bashkëpunimin ndërdisiplinor. Që nga themelimi i saj, Qendra ka synuar gjithashtu të ofrojë informacion dhe dokumentacion dhe të jetë pikë kontakti për mediet dhe publikun e interesuar rreth Evropës Juglindore, në kuptim të zhvillimeve politike, ligjore, ekonomike dhe kulturore. Ekipi ndërdisiplinor i juristëve, historianëve dhe politologëve që punojnë në Qendër ka kontribuar në kërkimet rreth Evropës Juglindore, me anë të shumë artikujve, monografive dhe botimeve të tjera. Përveç kësaj, Qendra rregullisht organizon konferenca dhe punëtori ndërkombëtare për t'i promovuar kërkimet më të avancuara për Evropën Juglindore.

Kontakti: UNIV.PROF. DR. FLORIAN BIEBER, Profesor i Studimeve të Evropës Juglindore, florian.bieber@uni-graz.at, +43 316 380 6822, Qendra për Studime të Evropës Juglindore, Universiteti i Graz-it, Universitätsstraße 15/K3, A-8010 Graz, Austria, www.suedosteuropa.uni-graz.at



www.biepag.eu

të shtypura në letër të ricikluar